



Center for Civil Communications
Центар за граѓански комуникации



center for
intercultural
dialogue



MUNGESË PËR PROCEDURA,
TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE
NË PROKURIMET QË FINANCOHEN
ME PARA PREJ PRINDËRVE
TË NXËNËSVE NË SHKOLLAT



Kingdom of the Netherlands



30 YEARS
DIPLOMATIC RELATIONS
WE SHINE TOGETHER

MUNGESË PËR PROCEDURA, TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE NË PROKURIMET QË FINANCOHEN ME PARA PREJ PRINDËRVE TË NXËNËSVE NË SHKOLLAT

Botim elektronik:

(Mungesë për procedura, transparencë dhe llogaridhënie në prokurimet që financohen me para prej prindërve të nxënësve në shkollat)

Titulli origjinal i botimit:

Отсутствие на процедури, транспарентност и отчетност кај набавките коишто се финансираат со пари од родителите во училиштата

Botuesi:

Qendra për Komunikime Qytetare

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe:

Agon Ismaili

Dizajn grafik:

Relativ

Shkup, mars 2024



Kingdom of the Netherlands

Hulumtimi është përgatitur në kuadër të projektit “Mbrotje nga korrupsioni”, me ndihmën financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shkup, i implementuar nga Qendra për Komunikime Qytetare, në periudhën nga 1 nëntor 2021 deri më 31 tetor 2024.

PËRMBAJTJA

4	GJETJET KRYESORE
5	REKOMANDIME
6	OBJEKTIVI I HULUMTIMIT
7	Hulumtim mbi mënyrën e zbatimit të prokurimeve që financohen me para prej prindërve të nxënësve në shkollat e Komunës së Manastirit
18	Hulumtim mbi mënyrën e zbatimit të prokurimeve që financohen me para prej prindërve të nxënësve në shkollat e Komunës së Kërçovës
24	Hulumtim mbi mënyrën e zbatimit të prokurimeve që financohen me para prej prindërve të nxënësve në shkollat e Komunës së Kumanovës
34	Hulumtim mbi mënyrën e zbatimit të prokurimeve që financohen me para prej prindërve të nxënësve në shkollat e Komunës Negotinë
38	Hulumtim mbi mënyrën e zbatimit të prokurimeve që financohen me para prej prindërve të nxënësve në shkollat e Komunës së Strumicë
46	Hulumtim mbi mënyrën e zbatimit të prokurimeve që financohen me para prej prindërve të nxënësve në shkollat e Komunës së Tetovës
54	Hulumtim mbi mënyrën e zbatimit të prokurimeve që financohen me para prej prindërve të nxënësve në shkollat e Komunës Çair
60	Hulumtim mbi mënyrën e zbatimit të prokurimeve që financohen me para prej prindërve të nxënësve në shkollat e Komunës së Shtip
69	Rregulloret për realizimin e ekskursioneve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore për arsimin fillor dhe të mesëm

GJETJET KRYESORE

- Hartimi i akteve nënligjore me vonesë nga Ministria për Arsim dhe Shkencë (MASH), me të cilat do të rregullohet mënyra e zbatimit të prokurimeve në institucionet arsimore¹, e të cilat nuk i nënshtrohen Ligjit për Prokurime Publike, ua mundëson shkollave të mos jenë transparente dhe llogaridhënese për mënyrën se si shpenzohen paratë e prindërve. Në Strategjinë nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2021-2025 është paraparë që Ministria për Arsim dhe Shkencë t'i ketë hartuar këto akte nënligjore (rregullore) qysh në gjysmën e parë të vitit 2022 me qëllim të reduktimit të mundësive të shumta për korrupsion dhe keqpërdorime të pozitave zyrtare.
- Hulumtimi i realizuar në 96 shkolla fillore dhe të mesme në 8 vetëqeverisje të vendit e nxjerr në pah faktin që prokurimet për sigurimin e nxënësve, uniforma për nxënësit, fotografim, shujtë, etj., zbatohen në procedura për të cilat nuk ka rregulla të përcaktuara në mënyrë të qartë, e të cilat do të mundësonin përzgjedhjen e ofertave më të favorshme dhe vlerën më të mirë për paratë e shpenzuara. Shpalljet publikohen vetëm për ekskursionet për shkak që për to, MASH ka miratuar procedura qysh në vitin 2014.
- Pjesa më e madhe nga shkollat nuk mund të sqarojnë se në çfarë mënyre është bërë përzgjedhja e kompanive për shërbimet e të cilave paguajnë prindërit. Madje, edhe për ato shkolla të cilat i dërguan vendimet për përzgjedhjet nga Këshilli i Prindërve, nuk mund të verifikohet se në çfarë mënyre janë grumbulluar ofertat e shqyrtuara, përkatësisht kush ka vendosur se nga cilat kompani konkrete të kërkohen oferta për prokurimet.
- Drejtoritë e thujtë të gjitha shkollave distancohen nga procesi i realizimit të këtyre prokurimeve me pohimin që nuk i mbledhin paratë prej prindërve, por që pagesa u bëhet drejtpërsëdrejti kompanive të përzgjedhura. Së këtejmi, shkollat janë ndarë në dy grupe. Grupi i parë i shkollave i kanë dorëzuar informacionet e kërkuara për llojin e prokurimeve dhe shumën e shpenzimeve për to, ndërsa shkollat nga grupi tjetër as nuk deshën të na i dorëzojnë informacionet e kërkuara, duke u distancuar plotësisht nga ky proces. Kjo situatë flet për vetëdijen e ulët për llogaridhënie lidhur me këto shpenzime dhe natyrisht për atë që i tërë procesi të jetë i rregulluar me një ndonjë akt të brendshëm, si dhe për t'u siguruar transparenca dhe ligjshmëria e tyre.
- Ndërkaq, shkollat që i kanë dorëzuar të dhënat, kanë dorëzuar informacione shumë të ndryshme për sa i përket listës dhe vlerës së produkteve dhe shërbimeve që financohen me paratë e prindërve të nxënësve. Kjo tregon që disa shkolla mund të kenë dërguar vetëm një pjesë të informacioneve përkundër faktit që ato janë kërkuar në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik.
- Shkollat nuk i përdorin faqet e tyre të internetit për t'i publikuar informacionet përkatëse në lidhje me prokurimet e financuara me paratë e prindërve të nxënësve, as për të publikuar informacione se me cilat subjekte juridike janë lidhur kontratat si dhe në çfarë mënyre është bërë përzgjedhja e subjekteve. Numri më i madh i shkollave nuk kanë faqe funksionale të internetit.
- Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë 966 shkolla fillore dhe 129 shkolla të mesme në të cilat mësojnë rreth 254 mijë nxënës. Nga të dhënat e fituara, vlera vjetore e këtyre prokurimeve mund të vlerësohet se është së paku 10 milionë euro. Kjo gjithsesi është një shumë jashtëzakonisht e madhe parash për të cilën nuk ka zgjidhje sistematike për mënyrën e shpenzimit të tyre për nevojat e nxënësve.

¹ Raport vjetor për zbatimin e Strategjisë nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2021-2025 për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023

SYNIMI I HULUMTIMIT

- » Hulumtimi bazohet në Strategjinë nacionale për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2021 – 2025 në të cilën konstatohet mungesë e procedurave për prokurime, të cilat në institucionet edukative-arsimore realizohen jashtë normave të Ligjit për Prokurime Publike. Përkatësisht, në institucionet edukative-arsimore realizohet një numër i madh procedurash për prokurime (ekskursione për nxënësit, sigurimi i shkollës, fotografimi i nxënësve dhe përgatitja e almanakëve, prokurim për shujtë, sigurimi i nxënësve etj.), zbatimi i të cilave është jashtë kornizave të dispozitave të Ligjit për Prokurime Publike. Ky lloj prokurimesh siguron mundësi të shumta për korrupsion dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare, ndërsa shpenzimet janë në kurriz të prindërve. MASH ka miratuar Rregullore për organizim të ekskursioneve, mirëpo mungojnë akte nënligjore dhe procedura për llojet tjera në prokurimet e këtij lloji. Në atë drejtim, nevojitet përpilim i akteve nënligjore me të cilat do të rregullohet mënyra e zbatimit të prokurimeve të cekura në institucionet edukative-arsimore.
- » Duke e pasur parasysh faktin që Strategjia është miratuar para 3 vitesh, ky hulumtim ka për qëllim të vërtetojë nëse ka ndryshime në mënyrat se si zbatohen prokurimet, të cilat financohen me paratë e prindërve në suazat e shkollave fillore dhe të mesme në 8 komunat e synuara – Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Negotinë, Strumicë, Tetovë, Çair dhe Shtip. Konstatimi i gjendjes faktike duhet të mundësojë edhe konstatimin e dobësive kryesore në proces me qëllim që të jepen udhëzime dhe rekomandime për kapërcimin e tyre.
- » Për sigurimin e të dhënave të nevojshme, në fillim të muajit tetor të vitit 2023, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në 8 komunat e synuara janë dërguar kërkesa të unifikuara për qasje tek informacionet me karakter publik në lidhje me prokurimet në institucionet arsimore, e të cilat janë të financuara me mjetet e prindërve të nxënësve. Me dërgimin e kërkesës për qasje tek informacionet me karakter publik, nga shkollat e përcaktuara fillore dhe të mesme, është kërkuar të jepen informacionet dhe dokumentet si në vijim: numri i përgjithshëm i nxënësve në vitin shkollor 2022/2023; listë e produkteve dhe shërbimeve, të cilat çdo shkollë i financon ndaras me mjete financiare të mbledhura prej prindërve të nxënësve në vitin shkollor 2022/2023; shuma totale e mjeteve financiare të shpenzuara në nivel të produktit/shërbimit; informacion për mënyrën se si zbatohen prokurimet dhe dërgim i akteve të brendshme sipas të cilëve veprojnë si dhe informacion nëse shkollat në ueb faqet e tyre publikojnë informacione lidhur me aktet e brendshme për blerjet e produkteve dhe shërbimet që financohen me para nga prindërit e nxënësve.

SYNIMI I HULUMTIMIT

Hulumtimi bazohet në Strategjinë nacionale për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2021 – 2025 në të cilën konstatohet mungesë e procedurave për prokurime, të cilat në institucionet edukative-arsimore realizohen jashtë normave të Ligjit për Prokurime Publike. Përkatësisht, në institucionet edukative-arsimore realizohet një numër i madh procedurash për prokurime (ekskursione për nxënësit, sigurimi i shkollës, fotografimi i nxënësve dhe përgatitja e almanakëve, prokurim për shujtë, sigurimi i nxënësve etj.), zbatimi i të cilave është jashtë kornizave të dispozitave të Ligjit për Prokurime Publike. Ky lloj prokurimesh siguron mundësi të shumta për korrupsion dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare, ndërsa shpenzimet janë në kurriz të prindërve. MASH ka miratuar Rregullore për organizim të ekskursioneve, mirëpo mungojnë akte nënligjore dhe procedura për llojet tjera në prokurimet e këtij lloji. Në atë drejtim, nevojitet përpilim i akteve nënligjore me të cilat do të rregullohet mënyra e zbatimit të prokurimeve të cekura në institucionet edukative-arsimore.

Duke e pasur parasysh faktin që Strategjia është miratuar para 3 vitesh, ky hulumtim ka për qëllim të vërtetojë nëse ka ndryshime në mënyrat se si zbatohen prokurimet, të cilat financohen me paratë e prindërve në suazat e shkollave fillore dhe të mesme në 8 komunat e synuara – Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Negotinë, Strumicë, Tetovë, Çair dhe Shtip. Konstatimi i gjendjes faktike duhet të mundësojë edhe konstatimin e dobësive kryesore në proces me qëllim që të jepen udhëzime dhe rekomandime për kapërcimin e tyre.

Për sigurimin e të dhënave të nevojshme, në fillim të muajit tetor të vitit 2023, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në 8 komunat e synuara janë dërguar kërkesa të unifikuara për qasje tek informacionet me karakter publik në lidhje me prokurimet në institucionet arsimore, e të cilat janë të financuara me mjetet e prindërve të nxënësve. Me dërgimin e kërkesës për qasje tek informacionet me karakter publik, nga shkollat e përcaktuara fillore dhe të mesme, është kërkuar të jepen informacionet dhe dokumentet si në vijim: numri i përgjithshëm i nxënësve në vitin shkollor 2022/2023; listë e produkteve dhe shërbimeve, të cilat çdo shkollë i financon ndaras me mjete financiare të mbledhura prej prindërve të nxënësve në vitin shkollor 2022/2023; shuma totale e mjeteve financiare të shpenzuara në nivel të produktit/shërbimit; informacion për mënyrën se si zbatohen prokurimet dhe dërgim i akteve të brendshme sipas të cilëve veprojnë si dhe informacion nëse shkollat në ueb faqet e tyre publikojnë informacione lidhur me aktet e brendshme për blerjet e produkteve dhe shërbimet që financohen me para nga prindërit e nxënësve.

Hulumtim mbi mënyrën e
zbatimit të prokurimeve që
financohen me para prej prindërve
të nxënësve në shkollat në
Komunën Manastir



TË DHËNAT PËR SHKOLLAT NGA KOMUNA E MANASTIRIT

- Procedurat për prokurim të produkteve/shërbimeve, shkollat fillore dhe shkollat e mesme nuk i zbatojnë nëpërmjet llogarive të shkollave, por ato i zbatojnë Këshilli i prindërve me subjektin që e siguron shërbimin ose produktin që kërkohet;
- Mjetet që paguhen nga prindërit e nxënësve më së shpeshti paguhen drejtpërdrejtë në llogarinë e subjektit që e siguron shërbimin ose produktin;
- Të gjitha shkollat fillore dhe shkollat e mesme nuk kanë akte të brendshme për zbatimin e procedurave për sigurim të shërbimeve ose produkteve;
- Shuma më e lartë e cilat paguhet nga prindërit e nxënësve është në lidhje me organizimin e ekskursioneve, veçanërisht ekskursionet gjeneratash të cilat organizohen në shkollat e mesme;
- Gjatë zbatimit të prokurimeve për shërbime ose produkte, shkollat veprojnë në përputhshmëri me Statutin e shkollës, Rregulloren për punë të Këshillit të prindërve dhe Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollorë të nxënësve të shkollave të mesme të përcaktuar nga MASH;
- Asnjëra prej të gjitha 19 shkollave fillore dhe shkollave të mesme nuk publikon akte të brendshme ose informacione lidhur me prokurimet për produkte dhe shërbime, e të cilat financohen nga prindërit e nxënësve.
- Numri më i madh i shkollave nuk kanë ueb-faqe funksionale ose nuk kanë ueb-faqe në përgjithësi.

PËRFSHIRJA E HULUMTIMIT

Hulumtimi i zbatuar në Komunën Manastir i ka përfshirë të gjitha shkollat fillore dhe shkollat e mesme. Në këtë komunë ka 12 shkolla fillore dhe 7 shkolla të mesme.

Në bazë të përgjigjeve që janë dërguar, është fituar informacion për numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar në shkollat fillore dhe të mesme në territorin e komunës Manastir për vitin shkollor 2022/2023 dhe numri i tyre është 7,541 nxënës në arsim fillor dhe 4,042 nxënës në arsim të mesëm apo gjithsej 11,583 nxënës në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme.

Prezantim tabelor i shkollave fillore

EMRI I SHKOLLËS FILLORE	NUMRI I NXËNËSVE NË VITIN SHKOLLOR 2022/2023
SHF "GJORGJI SUGAREV"	658
SHFK "ELPIDA KARAMANDI"	711
SHF "SHËN CIRILI DHE METODIJ"	415
SHF "DAME GRUEV"	734
SHF "KOLE KANINSKI"	810
SHF "SHËN KLIMENT OHRIDSKI"	1,045
SHF "TRIFUN PANOVSKI"	306
SHF "KËRSTE PETKOV MISIRKOV" FSH. BISTRICA	398
SHF "ALEKSANDAR TURUNXHEV" FSH. KUKUREÇANI	182
SHF "TODOR ANGELLEВСKI"	915
SHF "STIV NAUMOV"	837
SHFK "GOCE DELLÇEV"	530
	7,541

Prezantim tabelor i shkollave të mesme

EMRI I SHKOLLËS SË MESME	NUMRI I NXËNËSVE NË VITIN SHKOLLOR 2022/2023
SHMK "GJIMNAZI JOSIP BROZ TITO"	733
SHMKT "GJORGJI NAUMOV"	804
SHMK "TAKI DASKALLO"	733
SHMKE "JANE SANDANSKI"	567
SHMKB "KUZMAN SHAPKAREV"	42
SHMKM "D-R JOVAN KALLAUZI"	782
SHKOLLA SHTETËRORE E MUZIKËS	381
	4,042

HULUMTIMI I DETAJUAR

PROKURIME ME PARA TË PRINDËRVE TË NXËNËSVE NË SHKOLLAT FILLORE

Sipas të dhënave të fituara për kërkesat për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, një nga gjithsej dymbëdhjetë shkolla fillore (SHFK "Elpida Karamandi") ka dhënë përgjigje që në nivel të shkollës nuk mblidhen para nga prindërit e nxënësve.

Sa u përket shërbimeve dhe produkteve që janë përmendur nga shkollat tjera, në një pjesë të tyre ka përsëritje, përkatësisht në 10 prej gjithsej 12 shkollave fillore në territorin e komunës së Manastirit (pa SHFK "Shën Kliment Ohridski" dhe SHFK "Aleksandar Turunxhev" – fsh. Kukureçani) mblidhen mjete nga prindërit e nxënësve për sigurim vjetor të nxënësve. Gjithashtu, 7 prej 12 shkollave mbledhin para për fotografimin e nxënësve ose për fotografimin e nxënësve dhe përpunimin e almanakëve dhe 3 shkolla e bëjnë blerjen e uniformave për nxënësit. Sa i përket organizimit të ekskursioneve për nxënësit në shkollat fillore, nga gjithsej 12 shkolla, 5 janë përgjigjur që realizojnë ekskursione, ndërsa 3 nga 7 shkollat tjera fillore janë përgjigjur që për shkak të numrit të vogël të nxënësve nuk organizojnë ekskursione për nxënësit. Në të njëjtën kohë, nga njëra shkollë është dhënë informacion që mblidhen mjete financiare prej prindërve të nxënësve për sigurim në shkollën dhe në një shkollë fillore mblidhen mjete nga prindërit e nxënësve për vizitë në shfaqjet teatrale për nxënësve.

PASQYRË E SHËRBIMEVE QË JANË SIGURUAR NGA SHKOLLAT FILLORE

- * organizim i ekskursioneve * prokurimi i uniformave * sigurimet për nxënësit
- * Fotografim (individual, në grupe, gjysmë maturantë, CD..)
- * Sigurime nga fatkeqësitë * vizitat në shfaqje teatrore

Nga 4 shkolla fillore, edhe atë SHF "Gjorgji Sugarev", SHF "Trifun Panovski", SHF "Kërste Petkov Misirkov" fsh. Bistricë dhe SHFK "Goce Dellçev" është dhënë informacioni që në vitin shkollor 2022/2023 me mjetet financiare nga prindërit e nxënësve është siguruar vetëm shërbimi për sigurimin e nxënësve. Çmimi në këto katër shkolla, si dhe në shkollat tjera që e kanë siguruar këtë shërbim ka qenë 100 denarë për një nxënë. Më konkretisht, nga SHF "Gjorgji Sugarev" nuk kanë dhënë informacion për numrin e fëmijëve që e kanë përdorur këtë shërbim, që nuk është rast i njëjtë me të tre shkollat tjera përkatësisht, në SHF "Kërste Petkov Misirkov" fsh. Bistricë, 373 fëmijë kanë përdorur shërbimin për sigurimin e tyre dhe në këtë bazë janë mbledhur gjithsej 37.300 denarë. Pastaj, në SHF "Trifun Panovski" janë mbledhur 27.300 denarë nga 273 nxënës dhe në SHFK "Goce Dellçev" janë mbledhur 51.100 denarë nga 511 nxënës.

Në shkollën fillore "Shën Cirili dhe Metodij" mjetet prej prindërve të nxënësve janë mbledhur për sigurim e nxënësve dhe fotografimin e tyre. Çmimi për sigurimin ka qenë 100 denarë për çdo nxënë edhe në vitin shkollor 2022/2023 dhe në këtë bazë janë mbledhur 32.000 denarë, ndërkaq, për fotografimin çmimi ka qenë 50 denarë për çdo nxënë kurse në këtë bazë shkolla ka mbledhur 22.000 denarë. Gjithashtu, në shkollën fillore "Dame Grujev" mjetet që janë mbledhur nga prindërit kanë qenë për sigurimin e katër shërbimeve edhe sigurimi i nxënësve, fotografimi, prokurimi i uniformave dhe realizimi i ekskursioneve, mirëpo nga shkollat nuk janë dhënë informacione për shumën e përgjithshme dhe veçmas për secilin nga këto shërbime, përkatësisht, prej tyre kemi qenë të udhëzuar të drejtohem te Këshilli i prindërve për informacione më të hollësishme.

Në shkollën fillore "Kole Kaninski" me mjete të mbledhura prej prindërve janë siguruar 3 shërbime edhe atë shërbimi për sigurimin e nxënësve, ekskursionet dhe fotografimi. Çmimi individual për sigurim ka qenë 100 denarë, për fotografi (almanak dhe CD për festën e gjysmë maturës 700 denarë për një nxënë dhe fotografi në grup 50 denarë për secilin nxënë, ndërsa për ekskursionet 1000 denarë për një nxënë të klasës së tretë dhe 3950 denarë për nxënë të klasës së gjashtë). Në të gjitha këto baza janë mbledhur gjithsej 466,850 denarë ose 75,200 denarë për sigurim të nxënësve, 67,200 denarë për fotografimin e nxënësve (almanak dhe CD), 36,200 denarë për fotografim në grup, 71,000 denarë ekskursionet për klasat e treta dhe 217,500 denarë për nxënësit e klasave të gjashta.

Viti shkollor 2022/2023 ka qenë viti me numrin më të madh të nxënësve që kanë mësuar në shkollën fillore "Shën Kliment Ohridski", edhe atë 1 045 nxënës, të cilët me mjetet financiare të mbledhura nga prindërit e tyre kanë siguruar 3 shërbime (mësimi në natyrë për nxënësit e klasave të pesta, fotografimi i nxënësve të secilës paralele dhe prokurimi i uniformave). Çmimi për mësim në natyrë për një nxënë të klasave të pesta ka qenë 3,420 denarë, për fotografim (në grup) 50 denarë për çdo nxënë, për fotografi individuale 40 denarë, ndërsa për blerjen e uniformave, më saktësisht për një komplet me xhup dhe një bluze me mëngë të shkurtra, çmimi ka qenë prej 1,000 deri në 1,150 denarë, varësisht prej madhësisë së produkteve. Nga shkolla nuk kemi fituar asnjë informacion për shumën totale të mjeteve

financiare të mbledhura ndërsa arsyetimi i tyre është se nuk kanë të dhëna të tilla dhe për këtë duhet t'i drejtohem Këshillit të prindërve.

Në shkollën fillore **"Todor Angellevski"** janë siguruar katër lloje të shërbimeve, përkatësisht sigurim në shkollë, sigurimi i nxënësve, organizimi i ekskursioneve (për klasat e treta, të pesta, të gjashta dhe të nënta) dhe fotografimi i nxënësve (individualisht dhe në grup). Sigurimi në shkollë, si shërbim është përmendur vetëm nga kjo shkollë dhe për këtë shërbim nxënësit në mënyrë individuale kanë paguar shumë prej 150 denarë ose në shumë totale, nga prindërit janë mbledhur mjete në vlerë prej 56,640 denarë. Sa i përket sigurimit të nxënësve, çmimi për një nxënës ka qenë 100 denarë, ndërsa për këtë shërbim kanë paguar 735 nxënës, përkatësisht janë mbledhur gjithsej 73,500 denarë. Sa i përket fotografimit, çmimi për fotografim individual ka qenë 40 denarë, ndërsa për fotografim në grup 50 denarë dhe për këtë shërbim prindërit kanë paguar gjithsej 64,220 denarë. Në kuadër të organizimit të ekskursioneve për klasat e treta, të pesta, të gjashta dhe të nënta, prindërit e nxënësve kanë paguar gjithsej 1,223,920 denarë, që është shuma më e madhe monetare që është mbledhur në mesin e shkollave fillore për të siguruar ndonjë shërbim ose produkt.

Shkolla fillore **"Stiv Naumov"** ka siguruar katër shërbime me çmimet individuale të mëposhtme për sigurimin e nxënësve - 100 denarë për çdo nxënës, për fotografim të gjysmë maturanëve - 600 denarë për çdo nxënës, për fotografi në grup - 50 denarë për çdo nxënës dhe për blerje të uniformave shkollore - 1,050 për çdo nxënës. Pas kërkesës së dërguar qasje tek informacionet me karakter publik, kemi fituar informacione vetëm për shumën individuale për çdo nxënës, me arsyetimin se në llogarinë e shkollës nuk paguhen mjetet e prindërve, përkatësisht prindërit i paguajnë mjetet drejtpërdrejt në llogaritë e subjekteve që i sigurojnë shërbimet.

Në shkollën fillore **"Aleksandar Turunxhev"** fsh. Kukureçani janë siguruar vetëm dy shërbime edhe atë shfaqje në teatër me çmim prej 140 denarë për një person dhe fotografi e gjysmë maturanëve me çmim prej 1000 denarë për çdo nxënës dhe fotografimi i nxënësve të klasave tjera 50 denarë. Shuma e përgjithshme e mbledhur prej mjeteve të prindërve ka qenë 13,160 denarë për shfaqje teatrore, 21,000 për fotografimin e gjysmë maturanëve dhe 8,050 për fotografimin e nxënësve të klasave tjera. Sipas informacioneve të këtylla rezulton se në shkollat fillore, shuma më e vogël financiare e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve janë mbledhur në SHF "Trifun Panovski", edhe atë në shumë totale prej 27,300 (që janë mbledhur në bazën për sigurimin e nxënësve.), ndërsa shuma më e lartë e mjeteve financiare të mbledhura prej prindërve të fëmijëve është në SHF "Todor Angellevski" në shumë të përgjithshme prej 1,418,420 (në bazën për sigurim në shkollë 57,000 denarë, në bazën për sigurimin e nxënësve 73,300 denarë, në bazën për fotografim 64,220 denarë dhe në bazën për ekskursionet 1,223,900 denarë).

Prezantim tabelor i shkollave fillore

Emri i shkollës fillore	Shërbimet veçmas dhe çmimi i tyre për çdo nxënës	Vlera totale për të gjitha shërbimet në denarë
SHF "Gjorgi Sugarev"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit – 100 denarë 	Shkolla nuk i ka dërguar informacionet e kërkuara
SHF "Shën Cirili dhe Metodij"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit – 100 denarë • Fotografim – 50 denarë 	54.000
SHF "Dame Gruev"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit - nuk është dhënë asnjë informacion • Fotografi - nuk është dhënë asnjë informacion • Prokurimi i uniformave – nuk është dhënë asnjë informacion • Ekskursione - nuk është dhënë asnjë informacion 	Shkolla nuk i ka dërguar informacionet e kërkuara
SHF "Kole Kaninski"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit – 100 denarë • Fotografimi për ceremoninë e semi-maturës - 700 denarë • Foto grupi – 50 denarë • Ekskursion për klasat e treta - 1.000 denarë • Ekskursion për klasat e gjashta - 3.950 denarë 	466.850
SHF "Shën Klementi i Ohrit"	<ul style="list-style-type: none"> • Mësimi në natyrë për klasat e pesta - 3.420 denarë • Fotografi grupi - 50 denarë • Fotografi individuale - 40 denarë • Prokurimi i uniformave - nga 1.000 deri në 1.150 denarë 	Shkolla nuk i ka dërguar informacionet e kërkuara
SHF "Trifun Panovski"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit – 100 denarë 	27,300
SHF "Kërste Petkov Misirkov" – fsh. Bistricë	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit – 100 denarë 	37,300
SHF "Aleksandar Turundjev" – fsh. Kukureçani	<ul style="list-style-type: none"> • Fotografim i nxënësve semi-maturantë - 1000 denarë • Shfaqje teatrore – 140 denarë 	42.210
SHF "Todor Angellevski"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi në shkollë - 150 denarë • Sigurimet për nxënësit - 100 denarë • Ekskursion për klasat e treta - 1.000 denarë • Ekskursion për klasat e pesta - 4.350 denarë • Ekskursion për klasat e gjashta - 3.950 denarë • Ekskursion për klasat e nënta – 5.680 denarë • Fotografi grupi - 50 denarë • Fotografi individuale - 40 denarë 	1.418.420
SHF "Stiv Naumov"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit - 100 denarë • Fotografim i gjysmë maturantëve - 600 denarë • Fotografi grupi - 50 denarë • Prokurimi i uniformave shkollore - 1.050 denarë 	Shkolla nuk i ka dërguar informacionet e kërkuara
SHF "Goce Dellçev"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit – 100 denarë 	51.100
SHF "Elpida Karamandi"	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk është dhënë asnjë informacion 	Kanë deklaruar që nuk zbatojnë prokurime të financuara me para prej prindërve të nxënësve të tyre.

Siç mund të shihet nga prezantimi tabelor, ka dallime të mëdha në informacionet e fituara, më konkretisht në shumat e shpenzimeve që janë bërë. Me të drejtë mund të konstatojmë që evidencë e saktë është dorëzuar vetëm nga SHF "Todor Angellevski".

Kjo gjithsesi sugjeron në evidencë të dobët lidhur me këto kosto dhe vetëdije të ulët të shkollave se ato janë përgjegjëse për të dhënë llogari për ato. Pohimi që edhe vetë prindërit janë të përfshirë në atë proces dhe se me këtë janë respektuar të gjitha detyrimet nuk është në frymën e gjetjeve të cekura në Strategjinë nacionale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave 2021-2025.

PROKURIMET ME PARA PREJ PRINDËRVE TË NXËNËSVE NË SHKOLLAT E MESME

Situata në shkollat e mesme është identike me atë në shkolla fillore, përkatësisht vetëm nga një shkollë e mesme, nga Shkolla Shtetërore e Muzikës në Manastir janë prononcuar se nuk ka listë të produkteve dhe shërbimeve që janë financuar me mjete financiare nga prindërit e nxënësve. Gjashtë shkollat tjera janë përgjigjur se bëhen prokurime për shërbime dhe produkte që financohen me mjete nga prindërit.

Shkolla e mesme **“Kuzman Shapkarev”** e ka siguruar vetëm shërbimin për sigurim dhe atë shërbim e kanë përdorur 42 nxënës, përkatësisht në këtë bazë janë mbledhur gjithsej 4.200 denarë.

Përkatësisht, 4 shkolla të mesme në vitin shkollor 2022/2023 kanë siguruar të njëjtat shërbime, edhe atë sigurimin e nxënësve dhe organizim i ekskursioneve. Koncretisht, nga SHMK **“Josip Broz Tito”** kanë dhënë informacion që shuma individuale për shërbimin për sigurim të nxënësve ka qenë 100 denarë dhe këtë shërbim e kanë përdorur 660 nxënës, përkatësisht janë mbledhur gjithsej 66,000 denarë, ndërkaq shuma individuale për organizim të ekskursioneve për gjeneratat ka qenë 23,880 denarë përkatësisht, nga 131 nxënës janë mbledhur 3,128,280 denarë. Në shkollën e mesme **“Gjorgji Naumov”** nuk kanë të dhëna për totalin e mjeteve që janë mbledhur nga prindërit për sigurimin e këtyre shërbimeve, por kanë ndarë informacione që shuma individuale për shërbimin e sigurimit të nxënësve ka qenë 100 denarë, ndërkaq, për organizimin e ekskursionit shuma 18,900 denarë për çdo nxënës. Më tej, nga shkolla e mesme **“Jane Sandanski”** janë përgjigjur që shuma individuale për çdo nxënës për shërbimin e sigurimit të nxënësve ka qenë 100 denarë, ndërsa për organizimin e ekskursionit të gjeneratave ka qenë 22,690 denarë. Nuk kishte asnjë informacion në lidhje me shumën totale të arkëtuar për dy shërbimet, me arsyetimin se prindërit i kanë paguar paratë drejtpërdrejtë në llogarinë e agjencisë së sigurimeve dhe agjencisë së udhëtimit. E njëjta situatë për sa i përket llojit të shërbimeve të siguruara në vitin shkollor 2022/2023 është edhe në shkollën e mesme **“Taki Daskalo”**. Shërbimin për sigurime të nxënësve e kanë përdorur 622 nxënës dhe janë mbledhur gjithsej 62,200 denarë, ndërsa shërbimin në lidhje me organizimin e ekskursioneve e kanë përdorur 69 nxënës dhe në këtë bazë janë mbledhur gjithsej 1,359,300 denarë.

Numri më i madh i shërbimeve që janë siguruar me mjetet e mbledhura nga prindërit e nxënësve është në shkollën e mesme të mjekësisë **“Dr. Jovan Kalauzi”**. E njëjta shkollë, këtë vit shkollor ka siguruar 4 shërbime, nga të cilat, sigurimet e nxënësve dhe organizimi i ekskursioneve (sikur shumica e shkollave të tjera të mesme) dhe përveç këtyre dy shërbimeve, ato kanë siguruar edhe një shërbimin për fotografim të maturantëve, përpunim i tablosë (për këtë shërbim shkolla si institucion nuk ka pasur të drejtë dhe detyrim të ndihmojë apo ta organizojë) dhe prokurimi i uniformave. Në fushën e organizimit të ekskursioneve, shkolla ka organizuar 3 lloje të ekskursioneve, përkatësisht dy ekskursione njëditore, ekskursionin e parë Manastir – Ohër – Manastir me çmim prej 269 denarë dhe të dytin Manastir – Shkup – Manastir me çmim prej 465 denarë, si dhe një ekskursion të fundit për nxënësit e vitit të tretë me çmim prej 22,850 denarë. Për organizimin e këtij shërbimi, nga prindërit e nxënësve janë mbledhur gjithsej 2,178,807 denarë, përkatësisht për sigurimin e të gjitha shërbimeve nga prindërit e nxënësve janë mbledhur gjithsej 2,462,807 denarë.

PASQYRË E SHËRBIMEVE QË JANË SIGURUAR NGA SHKOLLAT E MESMEA

- * Prokurimi i uniformave
- * Organizimi i ekskursionit të gjeneratave
- * Sigurimet e nxënësve
- * Fotografim (individualisht, në grup, maturantë, për tablo...)

Për produktet dhe shërbimet e sipërpërmendura, e të cilat janë siguruar nga shkollat dhe janë financuar me mjetet e prindërve të nxënësve, është dërguar informacion se i gjithë procesi i prokurimit është realizuar përmes Këshillit të Prindërve dhe mjetet e mbledhura nuk janë paguar në një llogarinë e shkollave ose nga llogaria e shkollave, përkatësisht prindërit mjetet i kanë paguar drejtpërdrejtë te subjekti që ka siguruar shërbimin ose produktin.

Situata me shkollat e mesme është e njëjtë, gjegjësisht ato thirren në ndarje të informacioneve që i marrin përmes Këshillit të prindërve, për shkak të faktit që përmes tyre është bërë prokurimi i shërbimeve dhe produkteve, të cilat janë financuar me mjete e prindërve të nxënësve.

Nga gjithsej 7 shkolla të mesme në territorin e komunës së Manastirit, **SHMKB "Kuzman Shapkarev"** ka shumën më të vogël të mjeteve financiare të mbledhura dhe të paguara nga prindërit, në vlerë të përgjithshme prej 4.200 denarë (mjetet janë mbledhur në bazën e sigurimeve për nxënësit). Ndërkaq, **SHMK "Josip Broz Tito"** ka shumën më të madhe që është mbledhur prej mjeteve të prindërve të nxënësve, në vlerë të përgjithshme prej 3,194,280 denarë (3,128,280 denarë për ekskursione të gjeneratave dhe 66,000 denarë për sigurime të nxënësve). Duke e pasur parasysh faktin që shkollat sigurojnë shërbime/produkte të ndryshme, ka logjikë edhe dallimi për sa i përket shumës së mjeteve të mbledhura, e cila korrespondon me numrin dhe llojin e shërbimeve dhe produkteve të siguruara nga prindërit e nxënësve.

Shpenzimet me paratë prej prindërve të nxënësve të shkollave fillore në Komunën e Manastirit

Emri i shkollës së mesme	Shërbimet/produktet individuale dhe çmimi i tyre	Vlera totale për të gjitha shërbimet në denarë
SHMK "Josip Broz Tito"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit – 100 denarë • Ekskursion i gjeneratave – 23,880 	3.194.280
SHMKT "Gjorgji Naumov"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit – 100 denarë • Ekskursion – 18,900 MKD 	Shkolla nuk i ka dërguar informacionet e kërkuara
SHMK "Taki Daskalo"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit – 100 denarë • Ekskursion – 19,700 MKD 	1.421.500
SHMKE "Jane Sandanski"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit – 100 denarë • Ekskursion i gjeneratave – 22,690 MKD 	Shkolla nuk i ka dërguar informacionet e kërkuara
SHMKB "Kuzman Shapkarev"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit - 100 denarë 	4200
SHMKM "Dr. Jovan Kallauzi"	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet për nxënësit - 100 denarë • Ekskursion njëditor Manastir-Ohër-Manastir - 269 denarë • Ekskursion njëditor Manastir-Shkup-Manastir – 465 MKD • Ekskursion final për nxënësit e vitit të tretë – 22.850 denarë • Prokurim i uniformave <ul style="list-style-type: none"> - pallto - 1050 denarë - uniformë mjekësore - 1300 denarë - pantallona – 650 denarë - xhaketë e sipërme - 750 denarë 	2.462.807
Shkolla Shtetërore e Muzikës	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk janë siguruar shërbime nga shkolla me mjete të mbledhura prej prindërve të nxënësve 	Shkolla nuk i ka dërguar informacionet e kërkuara

Paralelisht me analizën për totalin e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve, në kuadër të këtij hulumtimi e kemi analizuar edhe çmimin për një nxënës për shërbimet dhe produktet që prokurohen në suazat e shkollës. Analiza ka treguar se për disa produkte dhe shërbime çmimet në bazë individuale janë të njëjtat në shkollat fillore dhe shkollat e mesme (në shkollat fillore edhe në shkollat e mesme, çmimi për sigurimet e nxënësve ka qenë 100 denarë). Për shërbimin për fotografim, më saktësisht për fotografi individuale, çmimi për një nxënës ka qenë 40 denarë, ndërsa për fotografi në grup 50 denarë. Dallimi në shërbimin për fotografim shfaqet vetëm te shkollat fillore, përkatësisht në fotografimin e gjysmëmaturantëve si shërbim shtesë, çmimi i të cilit lëviz nga 600 denarë e deri në 1000 denarë. Për më tepër, prokurimi i uniformave si shërbim, sipas përgjigjeve që i kemi fituar, është shfaqur vetëm në 2 shkolla fillore dhe 1 shkollë të mesme. Në këtë pjesë, është e kuptueshme që të ketë dallim në çmimin për një nxënës, i cili është prej 1,050 denarë deri 3,750 denarë, sepse vetë kompletet të cilat janë paraqitur nga shkollat përfshijnë numër të ndryshëm të pjesëve (xhup + këmbë me mëngë të shkurtra ose pallto + uniformë mjekësore + pantallona + xhaketë e sipërme).

Ekskursionet e organizuara në kuadër të shkollave fillore dhe të mesme paraqesin një shërbim që përfshin shumë më të madhe të mjeteve financiare të mbledhura prej prindërve të nxënësve. Në këtë pjesë, sërish sikur edhe në rastin me uniformat e shkollave, ka dallime në çmimet individuale që janë rezultat i ekskursioneve të ndryshme që janë organizuar, si për nga numri i netëve për qëndrim, ashtu edhe për nga lokacione/lokacionet ku janë është realizuar ekskursioni. Nga shkollat fillore është dërguar informacion që prej 12 shkollave, në 4 prej tyre janë organizuar ekskursione dhe çmimet individuale për realizimin e tyre fillojnë nga shuma prej 1,000 denarë dhe arrijnë shumë prej 5,680 denarë. Në shkollat e mesme 5 nga 7 shkolla kanë organizuar ekskursione, edhe atë, 4 prej tyre kanë organizuar vetëm ekskursion për gjeneratat, ndërsa shkolla e pestë nga ky grup ka realizuar 3 ekskursione, edhe atë një ekskursion gjenerate dhe dy vizita, një në Ohër dhe një në Shkup. Pikërisht edhe çmimi më i ulët për një nxënës është për një nga ekskursionet e organizuara - vizitë në Ohër, për të cilin çmimi ka qenë 269 denarë, ndërsa çmimi më i lartë për një nxënës ka qenë 23,880 denarë për ekskursion të gjeneratës.

REGULLAT DHE AKTET NË BAZË TË CILAVE VEPROJNË SHKOLLAT GJATË REALIZIMIT TË SHËRBIMEVE DHE PRODUKTEVE

Realizimin e ekskursioneve, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën bëhet përzgjedhja e ofertës, shkollat i zbatojnë në përputhje me Rregulloren për realizimin e ekskursioneve, rregullore të cilën e ka përcaktuar Ministria për Arsim dhe Shkencë (MASH).

Sa i përket informacionit lidhur me mënyrën se si zbatohen prokurimet dhe dërgimi i akteve të brendshme në bazë të cilave veprojnë shkollat, nga ato shkolla që kanë dërguar informacionin se nëpërmjet Këshillit të prindërve mbledhin mjete prej prindërve të nxënësve për prokurimin e shërbimeve apo produkteve të caktuara, të gjitha kanë theksuar që veprojnë në përputhje me Statutin e Shkollës për sa i përket pjesës së Këshillit të prindërve dhe që nuk kanë akte të përcaktuara të brendshme. Nga ana tjetër, prej analizës mbi statutet rezulton se ato nuk përmbajnë asnjë informacion lidhur me mënyrën se si zbatohen procedurat e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve me paratë prej prindërve.

Përgjigjet që janë fituar nga shkollat fillore sugjerojnë se ato veprojnë në përputhje me Rregulloren për punë të Këshillit të prindërve dhe nëse është e nevojshme formohen komisione që vendosin për ofertat. Nga njëra shkollë kanë theksuar se gjatë prokurimeve vepron në përputhje me Rregulloren për Prokurimet me vlerë e vogël. Sa u përket shkollave të mesme, sërish edhe tek ato veprohet në përputhje me Statutin e shkollës për sa i përket pjesës së Këshillit të prindërve, si dhe në përputhje me Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore për nxënësit.

Sa i përket çështjes që ka të bëjë me publikimin e akteve të brendshme dhe në bazë të cilave zbatohen prokurimet e produkteve dhe shërbimeve që financohen me mjetet e prindërve të nxënësve, në përgjigjet që na janë dërguar thuhet se asnjë shkollë nuk i ka publikuar aktet e brendshme në ueb faqen e vet. Përkatesisht, shumica prej tyre kanë deklaruar se nuk e bëjnë këtë për shkak se nuk kanë ueb faqe funksionale, faqet e tyre të internetit janë duke u përpunuar ose për shkakun që shkolla nuk ka fare faqe të saj të internetit.

Ajo që përfundimisht mund të konstatohet është se rreziku nga korrupsioni është i pranishëm në prokurimet me para prej prindërve të nxënësve në shkollat fillore dhe shkollat e mesme për arsye se nuk ka rregulla të qarta dhe konkrete sipas të cilave zbatohen këto procedura. Përkatesisht, për t'u siguruar vlera më e mirë e parave në prokurimet për nxënësit, nevojitet që të sigurohet transparencë e procesit dhe trajtim i barabartë i ofertuesve.



РУРАЛНА КОАЛИЦИЈА
KOALICIONI RURAL

Hulumtim mbi mënyrën e
zbatimit të prokurimeve që
financohen me para prej
prindërve të nxënësve në shkollat
e Komunës së Kërçovës

$$\begin{array}{l} 2+2=4 \\ 3+3=6 \\ 4+4= \\ 5+5=10 \\ 6+6= \\ 7+7= \end{array}$$

$$\begin{array}{l} 2 \times 2 = \\ 3 \times 3 = \\ 4 \times 4 = \\ 5 \times 5 = \\ 6 \times 6 = 36 \\ 7 \times 7 = \end{array}$$



TË DHËNAT PËR SHKOLLAT NGA KOMUNA E KËRÇOVËS

- Në territorin e komunës së Kërçovës aktive janë 9 shkolla fillore dhe 2 shkolla të mesme. Numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollat fillore është 3,253 nxënës, ndërsa numri i nxënësve të shkollave të mesme në vitin shkollor 2022/23 është 1,395 nxënës.
- Produktet dhe shërbimet që shkollat i prokurojnë me mjete prej prindërve janë të ndryshme, edhe atë: sigurimi individual i nxënësit, fotografimi për tablo, fotografimi në grup në fund të vitit shkollor, ekskursionet, festimi i maturës dhe diplomimi, si dhe prokurimi i uniformave - shërbim i cili është vërejtur vetëm në një shkollë fillore në këtë komunë.
- Sigurimi individual i nxënësve paraqet shërbim që e prokurojnë të gjitha shkollat dhe çmimi për këtë shërbim është identik, përkatësisht 100 denarë për një nxënës. Fotografia për tablo dallon, duke filluar prej 800 denarë deri në 1,300 denarë për një nxënës. Për ekskursionet, shuma për një nxënës dallon, edhe atë prej 800 denarë deri në 10,500 denarë, varësisht nga kohëzgjatja e ekskursionit.
- Duke qenë se shërbimet dhe produktet të cilat shkollat i prokurojnë janë të ndryshme dhe numri i nxënësve në secilën prej shkollave është i ndryshëm, dallojnë edhe shumatat e totalit të mjeteve financiare të mbledhura prej prindërve të nxënësve. Përkatësisht, më së shumti mjete prej prindërve të nxënësve ka mbledhur shkolla e mesme komunale "Drita", edhe atë në bazën për ekskursionet për nxënësit e viteve të treta dhe të katërta, 10,500 denarë për një nxënës të vitit të tretë dhe 8,000 denarë për një nxënës të vitit të katërt, ose gjithsej 2,266,122 denarë, ndërsa më së paku mjete janë mbledhur në shkollat të cilat mbledhin mjete prej prindërve vetëm në bazën për shërbimin e sigurimit individual të nxënësve dhe i cili kushton 100 denarë për një nxënës.
- Asnjëra nga shkollat fillore nuk ka akte të brendshme në bazë të të cilave i zbatojnë këto prokurime. Disa nga shkollat u thirrën në "Rregulloren e Ministrisë për Arsim dhe Shkencë për organizimin e ekskursioneve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore për shkollat fillore", e cila vlen vetëm për ekskursionet, por jo edhe për prokurimet tjera.
- Shkollat e mesme gjithashtu nuk kanë akte të brendshme në bazë të të cilave i zbatojnë prokurimet me mjetet e mbledhura prej prindërve dhe njëra prej tyre (SHMK "Mirko Mileski") pretendon se nuk mbledh fare mjete prej prindërve, përkatësisht distancohet nga procesi, duke e përsëritur atë që dihet tashmë se këto fonde nuk kalojnë nëpër llogarinë e transaksioneve të shkollës, por përfaqësuesit e prindërve i zbatojnë vetë prokurimet, i përzgjedhin ofertuesit dhe paguajnë për sigurimet e nxënësve, fotografimin për foto grupi ose për tablonë, për ekskursionet dhe të tjera.
- Asnjë shkollë fillore apo e mesme në territorin e komunës së Kërçovës nuk ka ueb faqe aktive, edhe pse në Rregulloren për shkollat fillore figuron se programet vjetore për aktivitete të tilla jashtëshkollore duhet të jenë në dispozicion për publikun në faqet e internetit të shkollave.

HULUMTIM I DETAJUAR

Në territorin e Komunës së Kërçovës procesi arsimor zhvillohet në kuadër të 9 shkollave fillore dhe 2 shkollave të mesme me gjithsej 4,648 nxënës në vitin shkollor 2022/2023 dhe gjithsej 4,149,082 denarë që janë mbledhur prej prindërve të nxënësve për prokurimin e produkteve dhe shërbimeve të ndryshme siç janë fotografimi, sigurimet e nxënësve, organizimi i ekskursioneve etj.

Prezantimi tabelor i shkollave, numri i nxënësve dhe shpenzimet e përgjithshme të financuara nga prindërit e nxënësve

Emri i shkollës	Numri i përgjithshëm i nxënësve	Vlera totale për të gjitha shërbimet në denarë
SHF "Millto Gura"	163	Shkolla nuk i ka dërguar të dhënat e kërkuara
SHF "Kuzman Josifoski-Pitu"	648	453,660
SHF "Naim Frashëri"	58	5,800
SHF "Gjerg Kastrioti-Skenderbegu"	87	60,900
SHF "Dr. Vladimir Polezhinski"	454	930,000
SHF "Hristo Uzunov"	134	33,400
SHF "Rexho Rushit Zajazi"	281	208,800
SHF "Faik Konica"	153	14,600 (jo të gjithë fëmijët e siguruar)
SHF "Sande Shterjoski"	1,428	124,300
SHMK "Mirko Mileski"	837	Shkolla nuk i ka dërguar të dhënat e kërkuara
SHMK "Drita"	558	2,317,622
SHMK "Drita"	558	2,317,622

SHKOLLA FILLORE

Në shkollën fillore "**Millto Gura**", nga fshati Strellci, Komuna e Kërçovës mësojnë gjithsej 163 nxënës. Sipas përgjigjes në kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, shkolla nuk zbaton prokurime që financohen me paratë e prindërve dhe nuk ka akte të brendshme për zbatimin e prokurimit të produkteve dhe shërbimeve që financohen me para të prindërve të nxënësve.

Në shkollën fillore "**Kuzman Josifoski-Pitu**", Kërçovë mësojnë gjithsej 648 nxënës. Sipas përgjigjes nga kjo shkollë, me paratë e prindërve aty sigurohen disa lloje shërbimesh dhe atë: sigurimi i nxënësve; fotografim për tablo; foto në grup; festa e diplomimit dhe festival "Potoçinja".

Për shërbimin e sigurimit, nga 100 denarë mblidhen prindërit për fëmijën e tyre - nxënës, me atë që sigurimi nuk është i detyrueshëm për nxënësit, por me vendim individual të prindërve. Fotografimi për tablo është bërë për 89 nxënës të klasës së 9-të në vitin shkollor 2022/2023 dhe secili nxënës ka paguar 900 denarë, përkatësisht, për këtë shërbim janë mbledhur gjithsej 80,100 denarë.

Për shërbimin fotografi në grup janë mbledhur gjithsej 64,800 denarë, përkatësisht 100 për nxënës, ndërsa për fotografitë individuale prindërit vendosin vetë nëse fëmija i tyre do të fotografohet ose jo. Ky shërbim kushton 50 denarë për një nxënës dhe janë mbledhur gjithsej 30,300 denarë. Për festën e semi-maturës, nxënësit kanë paguar nga 1,300 denarë ose gjithsej 89 nxënës kanë paguar gjithsej 115,700 denarë.

Shërbimi i fundit për të cilin prindërit kanë mbledhur para ka qenë për biletat për festivalin e fëmijëve, e i cili gjithashtu nuk ka qenë i detyrueshëm për nxënësit, kështu që në festivalin e fëmijëve kanë shkuar pjesë 303 nxënës, për çka kanë paguar nga 120 denarë, përkatësisht në këtë bazë janë mbledhur gjithsej 36,360 denarë. Pasqyrë për shumat totale të parave të mbledhura dhe për llojin e shërbimit, si dhe çmimin e shërbimeve për një nxënës individualisht është paraqitur edhe në tabelën nr. 1.

Tabela nr. 1 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e fondeve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHF “Kuzman Josifoski-Pitu”, Kërçovë

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi i nxënësve	63,200 denarë	100 denarë
Fotografi për në tablo	80,100 denarë	900 denarë
Foto në grup	64,800 denarë	100 denarë
Foto individuale	30,300 denarë	50 denarë
Festa e gjysmë maturës	115,700 denarë	1,300 denarë
Festivali “Potoçinja”	36,360 denarë	120 denarë
Gjithsej	453,660 denarë	

Shkolla nuk ka akte të brendshme për prokurimin e produkteve dhe shërbimeve që sigurohen me paratë e prindërve të nxënësve dhe as ueb faqja e shkollës nuk është aktive.

Në SHFQ “Naim Frashëri”, fshati Jagoll Dollenci, Kërçovë, në vitin shkollor 2022/23 mësimin e kanë vijuar gjithsej 58 nxënës. Me paratë e mbledhura nga shkolla financohet vetëm sigurimi personal i nxënësve dhe shuma e përgjithshme e mbledhur në këtë bazë është 5,800 denarë ose 100 denarë për një nxënës.

Ndërkaq, në shkollën fillore “Gjerg Kastrioti-Skenderbeu”, fshati Sërbicë në Kërçovë, në vitin 2022/2023 janë regjistruar gjithsej 87 nxënës. Si shërbime që i siguron shkolla me para që janë mbledhur prej prindërve të nxënësve janë cekur: sigurimet; fotografimi dhe ekskursionet.

Për shërbimin e sigurimit të nxënësve, secili nxënës paguan nga 100 denarë ose gjithsej 8,700 denarë janë mbledhur në këtë bazë, për fotografim gjithashtu nga 100 denarë, ndërsa për ekskursione 500 denarë për një nxënës individualisht ose gjithsej 43,500 denarë (Tabela nr. 2)

Tabela nr. 2 – Shërbimet, çmimet për shërbimet dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHF “Gjerg Kastrioti – Skenderbeu”

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi	8,700 denarë	100 denarë
Fotografi në grup	8,700 denarë	100 denarë
Ekskursione	43,500 denarë	500 denarë
Gjithsej	60,900 denarë	

Nuk ka akte të brendshme të miratuara në bazë të të cilave do të ishte zbatuar prokurimi i shërbimeve të lartpërmendura dhe shkolla nuk ka faqe interneti aktive.

Në shkollën fillore “D-r. Vladimir Polezhinoski” në vitin shkollor 2022/23 janë regjistruar gjithsej 454 nxënës. Shkolla, me mjetet e mbledhura prej prindërve të nxënësve, i siguron shërbimet si vijon: veshje pune/uniformë (1 xhup dhe 2 bluza polo) për çdo nxënës; ekskursion për nxënësit e klasave të nënta; fotografim në grup; fotografim për nxënësit e klasave të nënta dhe sigurimi i nxënësve.

Për uniformat e nxënësve, nga ana e prindërve janë paguar 1,650 denarë për një nxënës, përkatësisht për këtë janë mbledhur gjithsej 749,100 denarë, ndërsa për ekskursione prindërit kanë paguar nga 800 denarë për një nxënës, ndërsa për ekskursionin e nxënësve të klasave të 9-ta, gjegjësisht për 53 nxënës janë mbledhur 42,400 denarë. Prindërit kanë paguar nga 100 denarë për fotografim në grup, ndërsa 900 denarë për fotografim për tablo. Prindërit paguajnë nga 100 denarë për sigurimin e një nxënësi. Shuma e përgjithshme e mjeteve që janë mbledhur prej prindërve të nxënësve në vitin shkollor 2022/23 është 930,000 denarë. (Tabela nr. 3)

Tabela nr. 3 - Lloji i shërbimeve dhe çmimet për secilin shërbim që i kanë paguar prindërit në SHF “D-r. Vladimir Polezhinoski”

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Veshje pune/uniforme	749,100 denarë	1,650 denarë
Ekskursion për nxënësit e klasave të 9-ta	42,400 denarë	800 denarë
Fotografi në grup	45,400 denarë	100 denarë
Fotografim për tablo për nxënësit e klasave të 9-ta	47,700 denarë	900 denarë
Sigurimi i nxënësve	45,400 denarë	100 denarë
Gjithsej	930,000 denarë	

Në shkollën fillore “Hristo Uzunov”, në fshatin Drugovë, komuna e Kërçovës, numri i nxënësve që vijnë në mësimin e rregullt në vitin shkollor 2022/23 ka qenë 134 nxënës. Prindërit e këtyre nxënësve paguajnë për sigurimin e nxënësve nga 100 denarë (që nuk është e detyrueshme). Fotografimi i nxënësve të klasave të nënta bëhet duke mbledhur oferta nga studioli dhe duke përzgjedhur ofertën më të favorshme në praninë e të gjithë prindërve dhe arsimtarëve të klasës. Në vitin shkollor 2022/23 shuma ka qenë 1,000 denarë për një nxënës për fotografi në madhësi të ndryshme dhe për të bërë një tablo me almanak, si dhe për fotografim në mbrëmjen e maturës.

Në shkollën fillore “Rexho Rushit Zajazi” nga fshati Zajaz nuk kërkohen mjete nga prindërit në asnjë bazë, përveç në rastin për një ekskursion tregëtor të nxënësve nga klasat e 9-ta, për të cilin shuma ka qenë 5,800 denarë për një nxënës. Në vitin shkollor 2022/23, mësimin e kanë vijuar gjithsej 281 nxënës.

Në shkollën fillore “Faik Konica”, fshati Greshnicë, në vitin shkollor 2022/23 ka pasur gjithsej 153 nxënës dhe mjetet nga prindërit për nevojat e shkollës nuk janë kërkuar në asnjë bazë, përveç sigurimit personal, shërbim për të cilin prindërit kanë paguar nga 100 denarë, mirëpo është cekur që jo të gjithë nxënësit kanë qenë të siguar, por që janë siguar varësisht nga vendimi i prindërve. Sikur në shkollat tjera ashtu edhe në këtë shkollë nuk ka akte të brendshme në bazë të të cilave do të ishin zbatuar prokurimet publike që paguhet me paratë e prindërve të nxënësve.

Në shkollën fillore “Sande Shterjoski” në Kërçovë, në vitin shkollor 2022/23 mësimin e kanë vijuar gjithsej 1.428 nxënës në tri gjuhë mësimore: maqedonisht, shqip dhe turqisht, ndërsa shkolla në asnjë bazë nuk mbledh mjete nga prindërit e nxënësve përveç sigurimit personal të nxënësve në bazë vullnetare, në shumë prej 100 denarë për një nxënës.

SHKOLLAT E MESME

Në komunën e Kërçovës ka 2 shkolla të mesme dhe ato janë:

- SHMK “Mirko Mileski” dhe
- SHMK “Drita” ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe turqisht

SHMK “Mirko Mileski” procesin mësimor e realizon për gjithsej 837 nxënës në vitin shkollor 2022/23. Shkolla organizon nga një ekskursion të fundit dhe ekskursione shkencore njëditore në përputhje me Programin Vjetor të shkollës dhe në përputhje me Rregulloren për realizimin e ekskursioneve të përcaktuar nga MASH. Këto ekskursione financohen nga prindërit e nxënësve. Pagesën për ekskursionin e fundit e bëjnë prindërit drejtpërdrejtë në llogarinë e transaksionit të Agjencisë. Sigurimi i nxënësve bëhet në bazë vullnetare dhe nëpërmjet arkëtarit të klasës mjetet i paguhen kompanisë së sigurimit. E njëjta gjë vlen edhe për shërbimet për fotografim, mbrëmjen e maturës, ekskursionet shkencore njëditore, etj., kështu që, shkolla thekson që sipas gjendjes faktike të paraqitur nuk mbledh para prej prindërve në asnjë bazë ndërkaq edhe llogaria e transaksionit e shkollës është e bllokuar.

Në shkollën e mesme “Drita”, Kërçovë, në vitin shkollor 2022/23 numri i përgjithshëm i nxënësve ka qenë 558. Lista e produkteve dhe shërbimeve që i përmend shkolla janë ekskursionet shkencore dhe sigurimet e nxënësve. Nga prindërit e viteve të treta dhe viteve të katërta, për ekskursionet shkencore janë mbledhur dhe janë shpenzuar gjithsej 2,266,122 denarë. Harxhimi për një nxënës të vitit të tretë është 10,500 denarë, ndërsa për një nxënës të vitit të katërt 8,000 denarë. Sa i përket sigurimit personal në shkollë, çmimi për këtë shërbim është 100 denarë për një nxënës dhe sigurimi bëhet sipas dëshirës së prindit/kujdestarit të nxënësit. (Tabela nr. 4) Prokurimet e zbatuara për produktet dhe shërbimet e financuara me mjete nga prindërit e nxënësve janë bërë në përputhje me Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore për nxënësit e shkollave të mesme të miratuar nga Ministri për Arsim dhe Shkencë me numër arkivi 07-9992/3 nga 05.06.2014. Rregullorja është publikuar në ueb faqen e Ministrisë për Arsim dhe Shkencë dhe mund ta gjeni në linkun si vijon: <https://mon.gov.mk/stored/document/pravilnik%20ekskurzii%20sredno-nov%20final.pdf>

Tabela nr. 4 – Mjete të mbledhura prej prindërve të nxënësve për aktivitete jashtëshkollore në SHMK “Drita” - Kërçovë

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Ekskursione shkencore	2.266.122 denarë	Viti i tretë – 10,500 denarë Viti i katërt 8,000 denarë
Sigurimi i nxënësve	51.500 denarë	100 denarë
Gjithsej	2.317.622 denarë	

Hulumtim mbi mënyrën e
zbatimit të prokurimeve që
financohen me para prej
prindërve të nxënësve në shkollat
e Komunës së Kumanovës



TË DHËNAT PËR SHKOLLAT NGA KOMUNA E KUMANOVËS

- Produktet dhe shërbimet që shkollat i prokurojnë me mjete nga prindërit e nxënësve janë të ndryshme në të gjitha shkollat. Por, zakonisht ato janë sigurimet e nxënësve, ekskursione, shfaqje kinemaje, ekskursione, mësimi në natyrë dhe fotografimi. Shkolla e mesme "Pero Nakov", përveç shërbimeve tjera, nga prindërit e nxënësve mbledh para për shërbimin e rojës shkollore dhe për festën e maturës. Ndërsa, në SHAFM "Pançe Peshev", prindërit kanë financuar një pjesë të instrumenteve të tyre, për akordim dhe servisim të pianos, si dhe transportin e nxënësve.
- Bazuar në rezultatet e fituara, mund të konstatojmë që shuma e mjeteve financiare varet edhe nga numri i nxënësve të regjistruar në shkollat, sepse këto shërbime përdoren vullnetarisht. Që nënkupton një numër më të madh nxënësish dhe më tepër mjete financiare të mbledhura prej prindërve të tyre. Më së shumti mjete janë mbledhur nga prindërit e nxënësve në shkollën fillore "Koço Racin", përkatësisht 112,500 denarë në bazë të sigurimit të nxënësve dhe 1,989,250 denarë për ekskursione, ose gjithsej 2,101,750 denarë. Shkolla me më së paku mjete të mbledhura nga prindërit e nxënësve dhe atë vetëm në bazë të sigurimit të nxënësve është shkolla fillore "Vera Kotorka", e cila, gjithashtu është shkolla me numrin më të vogël të nxënësve.
- Vetëm pesë nga gjithsej shtatëmbëdhjetë shkolla fillore, ndër të cilat SHFK "Vera Kotorka" fshati Kleçovcë, SHFK "Bajram Shaban", SHFK "Naim Frasheri", SHAFM "Pançe Peshev" dhe SHFK "Koço Racin" pohojnë që kanë akte të brendshme në bazë të të cilave janë zbatuar prokurimet e produkteve dhe shërbimeve të financuara me paratë e prindërve. Mirëpo, këto akte (procedura) nuk janë publikuar në ueb faqet e shkollave dhe nuk na janë dërguar megjithëse janë kërkuar në pajtim me Ligjin për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik. Disa shkolla nuk kanë uebsajtin e tyre përveç faqes në 'Facebook'.
- Secila shkollë funksionon ndryshe, pra nuk kanë unifikim për sa u përket prokurimeve të produkteve dhe shërbimeve që financohen me para nga prindërit e nxënësve. Edhe shkollat e mesme edhe shkollat fillore komunale kanë dokumente të ndryshme dhe nuk kanë një rregullore zyrtare në të cilën do të ishin referuar shkollat.
- Disa nga shkollat, edhe pse në përgjigjet e dërguara deklarojnë që kanë akte dhe që i kanë të publikuara, ato ende nuk janë të arritshme për shkak të mosfunksionimit të ueb-faqeve të shkollave. E gjithë kjo çon në uljen e transparencës në punën e shkollave.

HULUMTIM I DETAJUAR

Në territorin e Komunës së Kumanovës, arsimit zhvillohet në 17 shkolla fillore komunale dhe 5 shkolla të mesme komunale, me gjithsej 14,907 nxënës dhe një total prej 4,137,820 denarë që janë mbledhur prej prindërve të tyre për prokurimin e produkteve dhe shërbimeve të ndryshme, siç është sigurimi i nxënësve, ekskursione, shërbime për fotografim, piknik, shfaqje në kinema etj.

Tabela nr. 1 – Prezantimi tabelor i shkollave, numri i nxënësve dhe shpenzimet e përgjithshme të financuara nga prindërit e nxënësve

Emri i shkollave fillore dhe të mesme	Numri i përgjithshëm i nxënësve	Vlera e përgjithshme e shërbimeve në denarë
SHFK "Bajram Shabani"	1,067	365,220
SHFK "Koço Racin"	1,241	2,101,750
SHFK "11 Tetori"	430	785,550
SHFK "Vuk Karaxhiq"	85	8,100
SHFK "Toli Zordumis"	487	426 800
SHFK "Braça Ribar" fsh. Tabanovcë	238	63,200
SHFK "Magdalena Antova"	674	66,700
SHFK "Vera Kotorka"	65	4,600
SHFK "Hristijan Karposh"	1,087	80,300
SHFK "Naim Frashëri"	1,173	108,600
SHAFM "Pançe Peshev"	215	117,000
SHFK "Vëllezërit Miladinovci"	1,263	Nuk është dërguar informacioni i kërkuar
SHFK "Kërste Misirkov"	1,003	Nuk është dërguar informacioni i kërkuar
SHFK "Kongresi i Manastirit"	225	Nuk është dërguar informacioni i kërkuar
SHFK "Karposh" fshati Umin dol	128	Nuk është dërguar informacioni i kërkuar
SHFK "Jeronim De Rada"	488	Nuk është dërguar informacioni i kërkuar
SHFK "Kirili dhe Metodi"	368	Nuk është dërguar informacioni i kërkuar
SHMK "Nace Bugjoni"	1,885	Nuk është dërguar informacioni i kërkuar
SHMK Gjimnazi "Sami Frashëri"	663	10,000 (Të dhënat janë të pjeshme)
SHMK "Goce Dellçev".	824	Nuk është dërguar informacioni i kërkuar
QRATP "Kiro Burnaz"	506	Nuk është dërguar informacioni i kërkuar
SHMK "Pero Nakov"	792	Nuk është dërguar informacioni i kërkuar
GJITHSEJ	14,907 nxënës	

SHKOLLAT FILLORE

Në SHMK "Koço Racin", në vitin shkollor 2022/2023 ka pasur të regjistruar gjithsej 1241 nxënës. Sipas përgjigjes nga shkolla, ajo me paratë e prindërve siguron disa lloje shërbimesh, edhe atë: sigurim i nxënësve, ekskursione dhe për piknik. Për shërbimin e sigurimit të nxënësve, prindërit paguajnë nga 100 denarë për një nxënës dhe ky shërbim është në bazë të vendimit personal. Ndërsa për sigurimin e nxënësve, në vitin shkollor 2022/2023 janë mbledhur gjithsej 112,500 denarë. Për piknik njëditor janë mbledhur nga 300 denarë për një nxënës. Ndërsa për ekskursionet janë mbledhur 1,932,150 denarë. Një pasqyrë për shumat e përgjithshme të parave që janë mbledhur, si dhe për llojin e shërbimeve dhe çmimin e shërbimeve për një nxënës individualisht është prezantuar edhe në tabelën nr. 2.

Tabela nr. 2 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma e përgjithshme e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHKM "Koço Racin" Kumanovë

Lloji i shërbimit/produktit	Çmimi për çdo nxënës individualisht në denarë	Vlera e përgjithshme në denarë
Sigurimi i nxënësve	100	112,500
Piknik njëditor	300	64,100
Ekskursion njëditor për klasat e 3-ta	1,449	192,962
Ekskursion njëditor për klasat e 5-ta	5,399	615,486
Ekskursion për klasat 6-ta	3,660	344,040
Ekskursion për klasat 9-ta	5,599	772,662
Shuma totale:		2,101,750

Shkolla i bën blerjet sipas akteve dhe dokumenteve të brendshme të miratuara, si p.sh.:

- Rregullore për mënyrën e realizimit të ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve
- Procedurat dhe aktivitetet e përdorura nga shkolla për të siguruar kujdesin dhe mbrojtjen e nxënësve
- Vendim i këshillit të prindërve

Në periudhën 2022/2023 janë publikuar aktet e brendshme dhe për momentin janë duke u azhurnuar. Në SHM "Braça Miladinovci" në vitin akademik 2022/2023 janë regjistruar gjithsej 1263 nxënës. Sipas përgjigjes nga shkolla, ajo me paratë e prindërve siguron disa lloje shërbimesh, përkatësisht: sigurimi i nxënësve, ekskursione dhe shërbime fotografimi. Sigurimi kushton 100 denarë për një nxënës dhe është me vendim sipas dëshirës. E gjithë procedura e sigurimit, ekskursioneve dhe shërbimeve të fotografimit kryhet nëpërmjet këshillit të prindërve dhe prindërit i paguajnë personalisht paratë kompanive të përzgjedhura. Ekskursionet realizohen sipas rregulloreve të përcaktuara nga MASH dhe në përputhje me Ligjin për Arsimin Fillor. Shkolla nuk ka akte të brendshme për prokurimin e produkteve dhe shërbimeve që financohen me paratë e prindërve.

SHFK "Vuk Karaxhiq" në vitin shkollor 2022/2023 ka pasur të regjistruar gjithsej 85 nxënës. Me paratë që janë mbledhur nga shkolla financohet vetëm sigurimi personal i nxënësve që kushton 100 denarë për një nxënës. Ndërkaq, shuma e përgjithshme që është mbledhur në këtë bazë është 8,100 denarë. SHFK "Vuk Karaxhiq" është e vetmja shkollë fillore që ka bërë sigurimin kolektiv të nxënësve në bazë të një akti të brendshëm, të cilin e ka publikuar në ueb faqen e vet më datë 04.11.2022.

SHFK "Magdalena Antova" në vitin shkollor 2022/2023 ka pasur të regjistruar gjithsej 674 nxënës. Sipas përgjigjes nga kjo shkollë, para prej prindërve shkolla mbledh për sigurimin personal të nxënësve,

100 denarë për një nxënës, ose gjithsej 66,700 denarë. Gjithashtu, në shkollë mbledhin para prej prindërve edhe për ekskursionet, por nuk e kanë cekur shumën që e kanë mbledhur për vitin shkollor 2022/2023. Ekskursioni realizohet në bazë të rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve, piknikëve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore për nxënësit e shkollave fillore, e miratuar nga MASH, nr. 12-13487/1, nga 19.11.2019. Ndërkaq, pagesën prindërit e bëjnë drejtpërdrejtë në agjencinë turistike, sipas ofertës së përzgjedhur. Për shërbimin e sigurimeve, shkolla formon një komision në nivel të shkollës, në të cilin marrin pjesë përfaqësues të prindërve dhe bëhet përzgjedhja e ofertës më të favorshme. Shkolla nuk i publikon aktet e brendshme, por prindërit njoftohen nëpërmjet këshillit të prindërve dhe përmes mbledhjeve prindërore si dhe të gjithë njoftohen me informacionet në lidhje me ekskursionet dhe sigurimet e nxënësve.

Në vitin shkollor 2022/2023, në SHMK "Hristijan Karposh" kanë qenë të regjistruar gjithsej 1,087 nxënës. Nga drejtoria e shkollës janë përgjigjur që me paratë prej prindërve ata sigurojnë disa lloje shërbimesh, edhe atë: sigurimin e nxënësve, ekskursione dhe shërbime për fotografim. Për shërbimin e sigurimit të nxënësve, ata kanë mbledhur gjithsej 80,300 denarë, mjete të cilat i janë paguar kompanisë së sigurimeve nga prindërit. Gjithashtu, mjetet financiare për realizimin e ekskursioneve të nxënësve prindërit i kanë paguar drejtpërdrejtë në agjenci udhëtimi. Edhe për shërbimet për fotografim nxënësit e kanë paguar agjencinë për fotografi. Shkolla ka kontrata, procesverbale dhe dokumente të tjera për sigurim të produkteve dhe shërbimeve, por ato nuk i publikon në ueb faqen e shkollës.

SHFK "11 Tetori" në vitin shkollor 2022/2023 ka pasur gjithsej 430 nxënës të regjistruar. Me paratë e prindërve, shkolla siguron disa lloje shërbimesh, edhe atë: sigurimin e nxënësve, ekskursione dhe fotografim, si dhe një almanak për klasat e 9-ta. Një pasqyrë e detajuar për shumën e mjeteve të mbledhura, si dhe për llojin e shërbimeve dhe çmimin e shërbimeve për një nxënës individualisht është paraqitur edhe në tabelën nr. 3.

Tabela nr. 3 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHFK "11 Tetori" Kumanovë

Lloji i shërbimit/produktit	Çmimi për një nxënës individualisht në denarë	Vlera totale në denarë
Sigurimi i nxënësve	100	39.800
Fotografi dhe Almanak për klasat 9-ta	800	33.600
Ekskursione për klasat e 5-ta	5.500	82.000
Ekskursione për klasat e 6-ta	3.700	103.550
Ekskursione për klasat e 9-ta	5.900	230.200
Shuma totale:		489.150

Në lidhje me shërbimin për sigurimin e nxënësve, në shkollë diskuton dhe vendos Këshilli i prindërve dhe shërbimi sigurohet nëpërmjet prokurimit të brendshëm me procedurë të mbyllur në prani të përfaqësuesve nga Këshilli i Prindërve, procedurë të cilën shkolla nuk ka detyrim ta publikojë në faqen e internetit. Edhe për ekskursionet vendoset në bazë të mendimit pozitiv nga këshilli i prindërve. Përfaqësuesit e prindërve nga secila klasë e nëntë vendosin për fotografim dhe almanak për nxënësit e këtyre gjeneratave pasi dërgimit të intern të ofertave në shkollë.

Në vitin shkollor 2022/2023, në SHFK "Bajram Shabani" të regjistruar ka pasur gjithsej 1,067 nxënës. Si produkte dhe shërbime të financuara me para të mbledhura prej prindërve, janë shërbimet e cekura

si më poshtë: sigurimi i nxënësve, ekskursione dhe shërbimet për fotografim. Një pasqyrë e detajuar për shumën e mjeteve të mbledhura, si dhe për llojin e shërbimeve dhe çmimin e shërbimeve për një nxënës individualisht është paraqitur edhe në tabelën nr. 4.

Tabela nr. 4 - Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHFK "Bajram Shabani" Kumanovë

Lloji i shërbimit/prodaktit	Çmimi për një nxënës individualisht në denarë	Vlera totale në denarë
Sigurimi i nxënësve	100	62.500
Ekskursione	3.100	238.700
Shërbime për fotografim	60	64.020
Shuma totale:		365.220

Nga shkolla janë përgjigjur që prokurimet për produktet dhe shërbimet e financuara me paratë prej prindërve të nxënësve janë zbatuar në bazë të akteve të brendshme të miratuara me shpallje, dokumentacionit për tender dhe komisionit për prokurime publike. Gjithashtu, nga shkolla u përgjigjën se ueb faqja e shkollës aktualisht nuk është funksionale. Megjithatë, nuk janë dërguar aktet e brendshme dhe dokumentet përkatëse të bashkëngjitura në shtojcë të këtyre përgjigjeve.

Në vitin akademik 2022/2023, në SHFK "Kërste Misirkov" të regjistruar ka pasur gjithsej 1,003 nxënës. Produktet dhe shërbimet që financohen nga prindërit e nxënësve për vitin shkollor 2022/2023 janë: mësim në natyrë për klasat e pesta, ekskursion për klasat e nënta dhe sigurimi i nxënësve. Një pasqyrë e detajuar për shumën e mjeteve të mbledhura, si dhe për llojin e shërbimeve dhe çmimin e shërbimeve për një nxënës individualisht është paraqitur edhe në tabelën nr. 5.

Tabela nr. 5 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHFK "Kërste Misirkov" Kumanovë

Lloji i shërbimit/prodaktit	Çmimi për një nxënës individualisht në denarë	Vlera totale në denarë
Mësimdhënie në natyrë për klasën e 5-të	5.600	476.000
Ekskursion për klasën IX	5.600	616.000
Sigurimi i nxënësve	100	90.700
Shuma totale:		1.182.700

Nga shkolla kanë deklaruar se prokurimet janë bërë në bazë të mendimeve pozitive të këshillit të prindërve dhe ato janë publikuar vetëm në tabelën e shpalljeve të shkollës.

SHFK "Toli Zordumis" në vitin akademik 2022/2023 të regjistruar ka pasur gjithsej 487 nxënës nga të cilët:

- Në SHFQ "Toli Zordumis" janë të regjistruar 134 nxënës që vijojnë mësimin në gjuhën maqedonase dhe 304 nxënës që vijojnë mësimin në gjuhën shqipe;
- Në SHR "Toli Zordumis" në fsh. Në Rezhanovcë janë regjistruar 49 nxënës të cilët vijojnë mësimin në gjuhën maqedonase.

Lista e produkteve dhe shërbimeve të financuara nga prindërit e nxënësve është si më poshtë: sigurimi i nxënësve, fotografim, shfaqje në kinema, ekskursione, piknik dhe mësimdhënie në natyrë. Një pasqyrë e detajuar për shumën e mjeteve të mbledhura, si dhe për llojin e shërbimeve dhe çmimin e shërbimeve për një nxënës individualisht është paraqitur edhe në tabelën nr. 6.

Tabela nr. 6 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHFK “Toli Zordumis” Kumanovë

Lloji i shërbimit/produktit	Çmimi për një nxënës individualisht në denarë	Vlera totale në denarë
Sigurim i nxënësve	100	31.100
Fotografim	120	21.600
Shfaqje në kinema	150	25.500
Ekskursione	6.300	151.200
Mësimdhënie në natyrë	6.800	122.400
Piknik	250	75.000
Shuma totale		426.800

Nga drejtoria e shkollës kanë thënë që shpenzimet e përmendura nuk vlejné për të gjithë nxënësit, përkatësisht, varet nga cila klasë janë. Shembull: në ekskursion shkojnë vetëm nxënësit e klasave të nënta; mësim në natyrë ndjekin vetëm nxënësit e klasave të pesta; pikniku është i paraparë për nxënësit e gjeneratave të klasave të treta deri në klasat e nënta.

Shkolla nuk ka të miratuara akte të brendshme për prokurimet e zbatuara, përveç Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore për nxënës që është përfshirë me programin vjetor për punë të shkollës, ndërsa e përpiluar nga MASH, si dhe nuk kanë asgjë të publikuar në ueb faqen e shkollës.

SHFK “Kongresi i Manastirit”, në vitin shkollor 2022/2023 të regjistruar ka pasur gjithsej 225 nxënës. Nga drejtoria e shkollës pohojnë se nuk kanë siguruar produkte dhe shërbime të financuara me para prej prindërve të nxënësve dhe se nuk kanë zbatuar prokurime të tilla, ashtu që nuk kanë as akte të brendshme.

SHFK “Karposh” fshati Umin Doll, Kumanovë, në vitin shkollor 2022/2023 ka pasur të regjistruar gjithsej 128 nxënës. Nga drejtoria e shkollës thonë se nuk kanë zbatuar prokurime për produkte dhe shërbime që janë financuar me para prej prindërve të nxënësve.

SHFK “Vera Kotorka” fsh. Kleçovcë, Kumanovë në vitin shkollor 2022/2023 ka pasur të regjistruar gjithsej 65 nxënës. Shërbimi i vetëm që e përdorin nxënësit, e që financohet nga prindërit e tyre është sigurimi i nxënësve. Çmimi për këtë shërbim është 100 denarë për një nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2022/2023 për sigurim të nxënësve janë mbledhur gjithsej 4,600 denarë. Prokurimet e zbatuara për produkte dhe shërbime të financuara me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve zbatohen në bazë të akteve ligjore, programit vjetor dhe konsultimeve ndërmjet prindërve. Aktet ligjore janë publikuar në ueb faqen e shkollës.

SHFK “Jeronim De Rada” në vitin shkollor 2022/2023 ka pasur të regjistruar gjithsej 488 nxënës. Nga drejtoria e shkollës pohojnë se nuk janë zbatuar prokurime për produkte dhe shërbime të financuara me para prej prindërve të nxënësve.

SHFK "Cirili dhe Metodij" fsh. Romanovcë në Kumanovë në vitin shkollor 2022/2023 të regjistruar ka pasur gjithsej 368 nxënës. Këtu përfshihen edhe nxënësit e shkollës rajonale në fshatin Agino Sello, nga të cilët 168 janë femra dhe 200 janë meshkuj. Mësimin në gjuhën maqedonase e kanë ndjekur 117 nxënës (ku bëjnë pjesë edhe nxënësit nga shkolla rajonale në fshatin Agino Sello) dhe 251 nxënës në gjuhën shqipe. Nga drejtoria e shkollës thonë se nuk zbatuar prokurime për produkte dhe shërbime të financuara me para prej prindërve të nxënësve.

SHFK "Braça Ribar" fsh. Tabanovcë, Kumanovë në vitin shkollor 2022/2023 ka pasur të regjistruar gjithsej 238 nxënës. Lista e produkteve dhe shërbimeve në këtë shkollë janë të financuara me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve në vitin shkollor 2022/2023 është si vijon: ekskursione, sigurim i nxënësve dhe shërbime për fotografim. Një pasqyrë e detajuar për shumën e mjeteve të mbledhura, si dhe për llojin e shërbimeve dhe çmimin e shërbimeve për një nxënës individualisht është paraqitur edhe në tabelën nr. 7.

Tabela nr. 7 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHFK "Braça Ribar" Kumanovë

Lloji i shërbimit/prodaktit	Çmimi për çdo nxënës individualisht në denarë	Vlera totale në denarë
Sigurimi i nxënësve	100	12.700
Ekskursione	350	40.000
Shërbime fotografike	50	10.500
Shuma totale:		63.200

Shkolla nuk ka përgatitur akte të brendshme për prokurimet e zbatuara për produktet dhe shërbimet e financuara me para prej prindërve të nxënësve.

Numri i nxënësve të regjistruar në **SHFK "Naim Frashëri"** në vitin shkollor 2022/2023 ka qenë 1173 nxënës, të ndarë në 55 paralele. Në këtë shkollë, nga prindërit e nxënësve janë financuar shërbimet së vijon: sigurimi i nxënësve, fotografimi dhe ekskursionet. Pasqyrë e detajuar për shumën e mjeteve të mbledhura, si dhe për llojin e shërbimeve dhe çmimin e shërbimeve për çdo nxënës individualisht është paraqitur edhe në tabelën nr. 8.

Tabela nr. 8 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHFK "Naim Frashëri" Kumanovë

Lloji i shërbimit/prodaktit	Çmimi për çdo nxënës individualisht në denarë	Vlera totale në denarë
Sigurim i nxënësve	100	50,000
Ekskursione	Informacioni nuk është dorëzuar	Informacioni nuk është dorëzuar
Shërbime për fotografi	60	58,600
Shuma totale		108,600

Në **SHAFM "Pançe Peshev"** numri i nxënësve të regjistruar në vitin shkollor 2022/2023 ka qenë 215 nxënës. Produktet dhe shërbimet që financohen me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve janë së vijon: ksilofon i brendit 'thomann', Marex Tornado Studio, akordim dhe servisim i instrumenteve piano dhe transport i nxënësve në linjën Kumanovë-Shkup-Kumanovë. Një pasqyrë e detajuar për shumën e mjeteve financiare për listën e përmendur më sipër është paraqitur edhe në tabelën nr. 9.

Tabela nr. 9 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHAFM “Pançe Peshev” Kumanovë

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë
Instrument muzikor Thomann THTX 3.0 ksilofon	24,800
Instrument muzikor Marex TND044TC Tornado studio	43,200
Akordim dhe servisim të pianove	45,000
Transport i nxënësve	4000
Shuma totale	117,000

Nga drejtorja e shkollës deklaruan se të gjitha shpenzimet përkatësisht prokurimet e zbatuara me mjetet financiare të prezantuara më sipër janë dedikuar në interes të nxënësve. Ndërkaq, prej dokumenteve përkatëse, shkolla ka dërguar vendimin e këshillit të shkollës nr. 02-56/1 nga 28.02.2023. Vendimi është publikuar në ueb faqen e shkollës.

SHKOLLAT E MESME

Në SHMK “Goce Dellçev”, Kumanovë, në vitin shkollor 2022/2023 të regjistruar ka pasur 824 nxënës. Nga drejtorja e shkollës pohojnë se nuk kanë zbatuar prokurime për produkte dhe shërbime që financohen me para prej prindërve të nxënësve. Së këtejmi, nuk kanë as akte të brendshme.

Në SHMK “Sami Frashëri” në vitin shkollor 2022/2023 janë regjistruar gjithsej 663 nxënës. Për sa i përket listës së produkteve dhe shërbimeve që financohen nga paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve, i vetmi shërbim i tillë janë ekskursionet. Gjithashtu, për këtë shërbim nuk mbledhin më tepër se 10,000 denarë. Shkolla nuk ka akte të brendshme.

Në SHMK “Pero Nakov”, në vitin shkollor 2022/2023 të regjistruar ka pasur gjithsej 792 nxënës. Prej tyre, 505 nxënës në paralelet maqedonase, kurse 287 nxënës në paralelet shqipe. Lista e produkteve dhe shërbimeve që financohen në shkollë me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve është si vijon: shërbimi i rojës shkollore për nxënësit, sigurimi i nxënësve, ekskursioni i fundi për nxënësit e viteve të treta, fotografimi për maturantët dhe festimi i maturës.

Një pasqyrë e detajuar e shumës totale të mjeteve financiare nga lista e sipërme është prezentuar edhe në tabelën nr. 10.

Tabela nr. 10 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në shkollën e mesme “Pero Nakov” Kumanovë

Lloji i shërbimit/produktit	Çmimi për çdo nxënës individualisht në denarë	Vlera totale në denarë
Shërbimi i rojës shkollore për nxënësit		29,000 (faturë mujore me TVSH)
Sigurimi i nxënësve (sipas dëshirës)	100	Informacioni i kërkuar nuk është dhënë
Ekskursioni i fundit (sipas dëshirës)	22,500	Informacioni i kërkuar nuk është dhënë
Fotografim për nxënësit maturantë		
- paralelet maqedonase	1.100	Informacioni i kërkuar nuk është dhënë
- paralelet shqip	1.200	

Në SHMK "Nace Buxhoni" në vitin shkollor 2022/2023 të regjistruar ka pasur gjithsej 1885 nxënës. Prej tyre, 848 nxënës kanë vijuar mësimin në gjuhën maqedonase, ndërsa 1,037 nxënës kanë vijuar mësimin në gjuhën shqipe. Ata kanë qenë të sistemuar në 73 paralele (35 paralele në gjuhën maqedonase dhe 38 paralele në gjuhën shqipe). Nga drejtoria e shkollës thonë se nuk kanë asnjë produkt apo shërbim të vetëm që nuk financohet nga paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve, që nënkupton se nuk kanë akte të brendshme.

Në QRTAP "Kiro Burnaz" në vitin shkollor 2022/2023 janë regjistruar gjithsej 506 nxënës. Prej tyre, 411 nxënës në paralele në të cilat mësimi është zhvilluar në gjuhën maqedonase dhe 95 nxënës në paralelet në të cilat mësimi është zhvilluar në gjuhën shqipe. Nga drejtoria e shkollës thonë se nuk kanë asnjë produkt apo shërbim të vetëm që financohet nga paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve. Ndërsa, nuk kanë as akte të brendshme.



Hulumtim mbi mënyrën e
zbatimit të prokurimeve që
financohen me para prej
prindërve të nxënësve në
shkollat në Komunës Negotinë



TË DHËNAT PËR SHKOLLAT NGA KOMUNA NEGOTINË

- Shërbimet, të cilat të gjitha shkollat në komunën Negotinë i prokurojnë me mjete të mbledhura prej prindërve të nxënësve janë pothuaj të njëjtat edhe atë: sigurimi personal i nxënësve, ekskursion njëditor ose dy ditor dhe fotografim për fotografi në grup dhe për tablonë për semi maturë.
- Shërbimi i sigurimit personal të nxënës është me çmim identik prej 100 denarë për secilin nxënës individualisht në secilën shkollë. E njëjta gjë vlen edhe për shërbimin e fotografimit. Shuma për një fotografi në grup është 70 denarë për një nxënës, ndërsa 730 denarë për përpunimin e tablosë për semi-maturantët.
- Shuma e parave që prindërit e nxënësve e kanë paguar është tjetër dhe fillon nga 600 e deri 800 denarë për ekskursion njëditor dhe prej 2,800 denarë deri 3,300 denarë për ekskursione dyditore.
- Shkollat në Komunën Negotinë kanë akte/rregullore të brendshme me të cilat përcaktohen kompetencat e këshillit të prindërve, mirëpo në to nuk janë specifikuar procedurat për zbatimin e prokurimeve.
- Rregullat për ekskursione aplikohen sipas Rregullores së Ministrisë për Arsim dhe Shkencë për mënyrën e realizimit të ekskursioneve, piknikëve dhe aktiviteteve tjera jashtëshkollore për nxënësit e shkollave fillore.
- Programet vjetore dhe rregulloret për mënyrën e punës janë të publikuar në ueb faqet e shkollave të komunës Negotinë.
- Asnjë nga shkollat nuk ka publikuar shpallje në ueb faqen e vet për të kërkuar oferta për shërbimet që i përdorin nxënësit, ndërsa të cilat janë të financuara nga prindërit e tyre.

HULUMTIM I DETAJUAR

Hulumtimi në Komunën Negotinë është bërë në 3 shkolla fillore, nga të cilat, 2 kanë shkolla rajonale në pjesët rurale të komunës.

SHFK "STRASHO PINXHUR"

Numri i përgjithshëm i nxënësve në SHFK "Strasho Pinxhur", në vitin shkollor 2022/23 ka qenë 663 nxënës në shkollën qendrore dhe 216 nxënës në shkollën rajonale. Shkolla i dërgoi informacionet për të dyja shkollat si të dhëna të përgjithshme.

Llojet e shërbimeve dhe vlera e tyre në SHFK "Strasho Pinxhur"

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë
Sigurimi i nxënësve	71,500
Fotografimi	62,400
Ekskursion dyditor	214,500
Ekskursion një ditor	63,700

Shuma e përgjithshme e mjeteve për sigurimin e nxënësve është 71,500 denarë. Në vitin shkollor 2022/23 janë të siguruar gjithsej 715 nxënës. Çmimi për sigurimin e nxënësve është 100 denarë individualisht.

Shuma prej 62,400 denarë është për fotografimin e nxënësve semi-maturantë për pako për një nxënës me çmim prej 730 denarë, ndërsa për nxënësit e tjerë, çmimi për fotografi grupi është 70 denarë për një nxënës.

Në vitin shkollor 2022/23, shkolla ka organizuar ekskursionet dyditore dhe njëditore. Ekskursionet njëditore kanë qenë të dedikuara për nxënësit e klasave të 6-ta dhe këtu bën pjesë edhe transporti në linjën Negotinë-Krushevë-Manastir-Prilep në vlerë prej 800 denarë për çdo nxënës individualisht, ndërkaq 83 nxënës kanë marrë pjesë. Ekskursionet dyditore është paraparë për nxënësit e klasave të 9-ta. Çmimi për çdo nxënës individualisht është 3,300 denarë dhe kanë udhëtuar 33 nxënës të klasave të nënta.

Nga drejtoria e shkollës është dhënë sqarimi që shkolla vetëm ndihmon në realizimin e shërbimeve pa ndërhyrë në vendimet e Këshillit të Prindërve, edhe atë:

- Shkolla ndihmon në sigurimin e ofertave për shërbimet e kërkuara dhe dorëzimin e ofertave te Këshilli i prindërve, pa asnjë ndërhyrje në dërgimin e vendimeve, mbledhjen e mjeteve financiare dhe realizimin e aktiviteteve të kërkuara.
- Të gjitha procedurat dhe aktivitetet shkolla i zbaton dhe realizon rreptësishtë në pajtim me rregulloren për Këshillin e prindërve.
- Procedurat para dhe pas realizimit të ekskursioneve zbatohen në përputhje me Rregulloren për realizimin e ekskursioneve të miratuar nga MASH dhe në përputhje me Ligjin për Arsim Fillor, pa ndërhyrë në pjesën financiare.

SHFKM "VLLADIMIR ARSOVSKI"

SHFKM "Vlladimir Arsovski" në vitin shkollor 2022/23 ka pasur 168 nxënës. Për shkak të specifikës së shkollës, ky institucion i angazhon prindërit e nxënësve të paguajnë mjete financiare vetëm për akordimin e instrumenteve nga 1,800 denarë në nivel vjetor. Mjetet financiare në llogarinë e shkollës janë duke u mbledhur gjatë këtyre 20 viteve të fundit dhe ato do të përdoren për ndërtimin e një godine të re shkollore. Nga drejtoria e shkollës thonë se nuk realizojnë ekskursione, nuk organizojnë fotografimin e nxënësve dhe nuk ka detyrime për sigurimin e nxënësve.

SHFK "GOCE DELLÇEV" - SH.R. NË FSHATIN DISAN I POSHTËM

Në shkollën rajonale në Disan të Poshtëm në vitin shkollor 2022/23 procesin mësimor e kanë ndjekur 90 nxënës.

Llojet e shërbimeve dhe vlera në SH.R. në fshatin Disani i Poshtëm

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë
Sigurimi i nxënësve	8,600
Fotografim	14,800
Ekskursion njëditor dhe dy ditor	63,800

Sigurimi i nxënësve nga fshati Disan i Poshtëm është 100 denarë për çdo nxënës individualisht.

Çmimi për fotografi për një nxënës individualisht është 70 denarë, me përjashtim të gjysmë-maturantëve, për të cilët shuma për një pako shërbimesh për çdo nxënës individualisht është 730 denarë.

Sipas Rregullores për ekskursione të miratuar nga MASH, realizohen dy lloje të ekskursioneve: për nxënësit e klasave të 3-ta, ekskursion njëditor në shumë prej 600 denarë për çdo nxënës individualisht, për nxënësit e klasave të 6-ta, ekskursion dyditor me çmim prej 2,800 denarë për çdo nxënës, ndërsa për nxënësit e klasave të 9-ta, ekskursion dyditor me çmim prej 2,950 denarë.

Përzgjedhja e ofertës më të favorshme bëhet ekskluzivisht me vendim të prindërve, të cilët vendosin në mbledhjen e Këshillit të prindërve.


SHFK "GOCE DELLÇEV" NEGOTINË

Çmimet për çdo nxënës veçmas, për të gjitha shërbimet janë të njëjta me SHFK "Goce Dellçev" në fshatin Disan i Poshtëm. Në lidhje me pyetjen për numrin e përgjithshëm të nxënësve, nga drejtoria e shkollës janë përgjigjur se shkolla ka 720 nxënës, por ky numër është numri i përgjithshëm me të gjitha shkollat rajonale të cilat janë pjesë e tyre. Bazuar në këtë, këto të dhëna nuk janë të sakta.

Llojet e shërbimeve dhe vlera në SH.F.K. në fshatin Disani i Poshtëm

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë
Sigurimi i nxënësve	Nuk na është dërguar asnjë informacion
Fotografim	Nuk na është dërguar asnjë informacion
Ekskursion njëditor dhe dy ditor	Nuk na është dërguar asnjë informacion

Hulumtim mbi mënyrën
e zbatimit të prokurimeve
që financohen me para prej
prindërve të nxënësve në
shkollat e Komunës së Strumicës



TË DHËNAT PËR SHKOLLAT NGA KOMUNA E STRUMICËS

- Shkollat në Strumicë shfrytëzojnë nga mjetet financiare prej prindërve të nxënësve për dedikime të ndryshme, duke përfshirë sigurimin e nxënësve, fotografimin, ekskursionet, prokurim të uniformave shkollore dhe aktivitete tjera.
- Çmimet e sigurimeve për nxënësit janë të standardizuara, ndërkohë që shpenzimet për shërbimet tjera dallojnë konsiderueshëm ndërmjet shkollave, varësisht prej llojit të aktiviteteve dhe vendimeve të shkollave apo atyre të këshillave të prindërve.
- Totali i mjeteve financiare të mbledhura prej prindërve të nxënësve dallon nga shkolla në shkollë, që i pasqyron numrat e ndryshëm të nxënësve dhe llojshmërinë e shërbimeve dhe aktiviteteve të ofruara.
- Pak shkolla kanë procedurë formale apo rregulla të brendshme për organizimin e aktiviteteve, të cilat janë financuara me mjete financiare prej prindërve, që sugjerojnë në nevojën për të përmirësuar kornizën e rregullimit dhe praktikën.
- Mungesa e ueb faqeve aktive të shkollave e bën të vështirë qasjen tek informacionet për aktivitetet jashtëshkollore të financuara nga prindërit dhe kjo e zvogëlon nivelin e transparencës dhe llogaridhënies.

Këto të dhëna sugjerojnë në nevojën për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien, standardizimin e procedurave dhe përfshirjen e prindërve në proceset vendimmarrëse për shfrytëzimin e mjeteve financiare që i mbledhin prej tyre.

HULUMTIM I DETAJUAR

Në komunën e Strumicës, për vitin shkollor 2022/2023 procesi arsimor është zhvilluar në kuadër të 9 shkollave fillore dhe 3 shkollave të mesme me gjithsej 7,928 nxënës. Shumica e shkollave, edhe pse me kohë i kanë dërguar përgjigjet ndaj kërkesave të dërguara për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, ato në realitet nuk i kanë dorëzuar informacionet e kërkuara.

Prezantimi tabelor i shkollave, numri i nxënësve dhe shpenzimet e përgjithshme të financuara nga prindërit e nxënësve

Emri i shkollës (fillore dhe të mesme)	Numri i përgjithshëm i nxënësve	Vlera totale për të gjitha shërbimet në denarë
SHFK "Sando Masev"	1,245	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara
SHFK "Vidoe Podgorec"	844	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara
SHFK "Nikola Vapcarov"	935	49,680
SHFK "Marshall Tito"	761	20,000 (të dhëna të pjesshme)
SHR "Marshall Tito" fsh. Murtino	446	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara
SHFK "Goce Dellçev" fsh. Veljusa	219	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara
SHFK "Dame Gruev" fsh. Kukullish	497	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara
SHFK "Geras Cunev" fsh. Prosenikovë	239	20,900
SHFK "Cirili dhe Metodij" fsh. Dabilje	157	211,450
SHMK "Jane Sandanski"	817	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara
SHMK "Nikolla Karev"	1,063	103,500 (të dhëna të pjesshme)
SHMKSHN "Dimitar Vllahov"	705	2,445,000

SHKOLLAT FILLORE

Nga shkolla fillore "Sando Masev" Strumicë me kohë dhe në mënyrë të përgjegjshme i kanë dërguar informacionet e kërkuara dhe përgjigjet për pyetjet që janë dërguar me kërkesën. Sipas informatave të dërguara: numri i nxënësve në vitin shkollor 2022/23, në SHF "Sando Masev" Strumicë ka qenë 1,245 dhe prej tyre, 645 kanë qenë meshkuj dhe 600 femra. Lista e produkteve dhe shërbimeve të financuara nga paratë që i kanë mbledhur prej prindërve të nxënësve në vitin shkollor 2022/23 janë ekskursionet, fotot për tablo, festa e semi-maturës dhe sigurimi i nxënësve.

Çmimi veçmas i produkteve dhe shërbimeve që financohen me paratë prej prindërve për një nxënës:

- Ekskursion për nxënësit e klasave të treta - 990 denarë
- Ekskursion për nxënësit e klasave të pesta – 6,990 denarë
- Ekskursion për nxënësit e klasave të gjashta – 3,990 denarë
- Ekskursion për nxënësit e klasave të nënta – 5,990 denarë
- Tablo për semi-maturantët, klasat e nënta – 1,200 denarë
- Festa e semi-maturës për klasat e nënta – 1,000 denarë
- Sigurimi i nxënësve për gjeneratat nga klasa e parë deri në klasën e nëntë - 100 denarë

Sigurimet e nxënësve dhe ekskursionet janë në bazë vullnetare dhe jo të gjithë nxënësit shkojnë në ekskursion si dhe jo të gjithë sigurohen. Nuk na është dërguar shuma totale e parave të mbledhura nga ana e shkollës.

Nga SHF "Sando Masev" thonë që nuk kanë organizuar prokurime publike për ushqim, shërbim të rojës shkollore sepse nuk zbatohet, ndërsa për të tjerat ekziston. Të gjitha prokurimet tjera janë të rregulluara në statutin e shkollës, programin vjetor të shkollës. Të gjitha aktet janë të publikuara në faqen e internetit.

SHFK "Marshalli Tito" Strumicë në vitin shkollor 2022/23 ka pasur të regjistruar 761 nxënës. Ndërsa i vetmi shërbim për të cilin prindërit e nxënësve në këtë shkollë ndajnë mjetet e tyre është sigurimi i nxënësve. Shuma individuale për sigurim për një nxënës është 100 denarë, sigurimi i nxënësve është në bazë opsionale dhe shumica e prindërve nuk i sigurojnë fëmijët e tyre, ndërsa për vitin e kaluar janë siguruar 200 nxënës dhe janë mbledhur 20,000 denarë. Sa i përket pyetjes nëse prokurimet për produktet dhe shërbimet e financuara me para nga prindërit e nxënësve janë zbatuar në bazë të akteve të brendshme të miratuara, përgjigja e shkollës është se nuk ka prokurime të tilla, pra nuk ka akte të brendshme dhe ato nuk janë të publikuara në ueb faqen e shkollës.

Sipas përgjigjes së dërguar nga **SHFK "Nikolla Vapcarov"** Strumicë, numri i nxënësve në vitin shkollor 2022/2023 ka qenë 935 nxënës. Lista e produkteve dhe shërbimeve që financohen me mjetet nga prindërit janë: sigurimi i nxënësve dhe rrobat e punës për nxënësit. Shuma për sigurimi e nxënësve është gjithsej 49,680 denarë, ndërsa për rrobat e punës 286,550 denarë. Sigurimi për një nxënës është 90 denarë, ndërsa për veshjet për punë, varet cili nxënës çka ka porositur (është vështirë të dihet për çdo nxënës, për shkak që këtu përfshihet një fanellë, bluzë dhe xhup ashtu që varet kush çka ka porositur, ndërkaq të gjitha produktet kanë çmime të ndryshme). Të gjitha prokurimet janë zbatuar nga shkolla në emër të prindërve edhe atë me vendim të Këshillit të prindërve. Këto të dhëna nuk janë publikuar në faqen e internetit.

Në përgjigjen nga SHFK "Vidoe Podgorec" na janë përgjigjur që numri i nxënësve në klasë të I (të parë) deri në klasë të IX (të nëntë) në vitin shkollor 2022/2023 është gjithsej 844 nxënës. Në vitin shkollor 2022/2023, nga paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve janë financuar shërbime të ngjashme: sigurimi i nxënësve, fotografim i nxënësve, prokurim i uniformave të nxënësve dhe organizim i ekskursioneve për nxënësit.

Për shërbimet e sipërpërmendura që financohen nga paratë e prindërve të nxënësve janë paguar shumat e paraqitura më poshtë:

- Për sigurimin e nxënësve shuma prej 100 denarë për një nxënës,
- Për fotografimin e nxënësve në klasat e IX (e nënta) shuma prej 1,400 denarë për një nxënës.

Për uniforma të nxënësve:

- Xhup 1,000 denarë,
- Bluzë me mëngë të gjata 550 denarë,
- Bluzë me mëngë të shkurtra 400 denarë.

Për ekskursionet për nxënësit:

- Për ekskursion njëditor me nxënësit e klasave të treta, shumë prej 1,200 denarë,
- Për ekskursion dyditor me nxënësit e klasave të gjashta, shumë prej 3,600 denarë,
- Për ekskursion treditor me nxënësit e klasave të nënta, shumë prej 4,900 denarë,
- Për mësim në natyrë me nxënësit e klasave të pesta, shumë prej 7,500 denarë.

Të gjitha shumat janë individuale për çdo nxënës, me atë që nga prindërit mjetet i kanë paguar drejtpërdrejtë në Agjencinë Turistike, kurse pjesa tjetër e tyre në llogarinë 787 të shkollës. Nuk na është dhënë shuma totale e parave të mbledhura nga ana e shkollës.

Prokurimet për shërbimet me mjetet financiare nga prindërit e nxënësve janë zbatuar në bazë të procedurave të zbatuara në përputhje me normat ligjore pozitive dhe ato janë të publikuara në ueb faqen e shkollës.

Në SHFK "Dame Gruev" fsh. Kuklish, në vitin shkollor 2022-23 ka pasur gjithsej 497 nxënës. Asnjë informacion nuk na është dhënë nga administrata e shkollës.

Në SHFK "Shën Cirili dhe Metodij" fshati Dabilje, në vitin shkollor 2022/23 numri i përgjithshëm i nxënësve ka qenë 157 nxënës. Lista e produkteve dhe shërbimeve që financohen nga prindërit janë sigurimet e nxënësve, ekskursionet dhe shërbimet për fotografim.

Shuma e përgjithshme e mjeteve të shpenzuara nga paratë prej prindërve të nxënësve për sigurimin e nxënësve është 15,500 denarë, për ekskursion të klasave të IX-ta shumë prej 72,350 denarë; klasat e VI-ta shumë prej 70,200 denarë; për klasat e III-ta shumë prej 32,400 denarë, ndërsa për fotografim gjithsej 21,000 denarë.

Për një nxënës individualisht, çmimi për sigurimin e nxënësve është 100 denarë; 1,400 për nxënës për fotografim për tablo; ekskursion i klasave të IX-ta me 14 nxënës secili nga 4,990 denarë, një nxënës si rast social me 2495 denarë, ekskursion i klasave të VI-ta me 19 nxënës secili nga 3,600 denarë një nxënës si rast social me 1800 denarë, ekskursion i klasave të III-ta me 27 nxënës nga 1,200 denarë.

Prokurimet e zbatuara janë realizuar në bazë të Vendimeve, të cilat na janë dërguar në shtojcë të përgjigjeve. Faqja e internetit e shkollës nuk funksionon, kështu që këto të dhëna nuk janë të publikuara.

SHFK "Marshall Tito" fsh. Murtino sipas përgjigjes së dërguar prej tyre kanë bërë të ditur se numri i nxënësve në shkollë në vitin shkollor 2022-23 ka qenë 446 nxënës.

Lista e produkteve të financuara nga paratë e prindërve: shërbime fotografimi, sigurim i nxënësve, ekskursionet dhe uniforma të nxënësve.

- Fotografimi për klasat e nënta – 1,450 denarë për një nxënës,
- Fotografimi për fundin e vitit shkollor 2022-23, nga 100 denarë çdo nxënës.
- Sigurimi i nxënësve për vitin shkollor 2022-23 - nga 100 denarë për një nxënës.

Ekskursionet e nxënësve:

- Ekskursion njëditor për klasat e treta, nga 1,200 denarë për një nxënës,
- Ekskursion dyditor për nxënësit e klasave të gjashta, nga 3,600 denarë për një nxënës,
- Ekskursion treditor për nxënësit e klasave të nënta, nga 4,990 denarë për një nxënës,
- Mësim në natyrë për klasat e pesta, nga 7,500 denarë për një nxënës,
- Uniforma të nxënësve 1,950 denarë për një nxënës.

Nuk na është dërguar shuma totale e parave të mbledhura nga shkolla. Bazuar në prokurimet e zbatuara për produkte dhe shërbime të financuara me para prej prindërve të nxënësve, ato zbatohen në përputhje me Rregulloren për realizimin e ekskursioneve të nxënësve dhe në pajtim me Sistemin e Byrosë për Prokurime Publike, ndërkaq nuk janë të publikuara në ueb faqen e shkollës.

SHFK "Geras Cunev" fsh. Prosenikovë, lidhur me kërkesën tonë na kanë dërguar të dhënat e kërkuara. Numri i nxënësve në vitin shkollor 2022/2023 në SHFK "Geras Cunev" - Prosenikovë është 239 nxënës. Me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve financohet vetëm sigurimi i nxënësve, shërbim i cili përdoret në bazë vullnetare. Vitin e kaluar shkollor 2022/2023 janë siguruar gjithsej 209 nxënës, që donë të thotë se shuma e përgjithshme e mjeteve financiare të shpenzuara është 20,900 denarë. Individualisht secili nxënës paguan nga 100 denarë në bazë vjetore për sigurim. Në mbledhjet e prindërve që mbahen në fillim të vitit shkollor, prindërit i informojnë për çmimin e sigurimit të nxënësve dhe ata prononcohen nëse do të pranojnë që fëmijët e tyre të jenë të siguruar. Këto informacione nuk publikohen.

Në SHFK Fshati "Goce Dellçev" fsh. Veljusa, në vitin shkollor 2022/2023 mësimin e kanë ndjekur 219 nxënës. Informacione tjera që janë kërkuar me kërkesën për informacione me karakter publik nuk janë dhënë nga administrata e shkollës.

SHKOLLAT E MESME

Në komunën e Strumicës ka 3 shkolla të mesme edhe atë:

Nga shkolla e mesme **“Jane Sandanski” Strumicë**, lidhur me kërkesën e dërguar nga organizata jonë, na njoftuan se në SHMK **“Jane Sandanski”** në fillim të vitit shkollor 2022/23 janë regjistruar 817 nxënës të rregullt, 17 nxënës me korrespondencë, ndërsa janë çregjistruar 29 nxënës gjatë vitit. Në lidhje me pyetjen e dytë për listën e shërbimeve që financohen në shkollë me paratë e prindërve të nxënësve për vitin 2022/23 nga SHMK **“Jane Sandanski”** thonë se shkolla nuk mbledh mjete financiare prej prindërve, por që prindërit paguajnë për shërbimet për fotografim, ekskursione dhe mbrëmjen e maturës.

SHMK **“Jane Sandanski”** me arsyetimin që shkolla nuk mbledh mjete financiare prej prindërve të nxënësve, nuk na dërgoi informacionet e kërkuara. Ndërkaq, për sa u përket shpenzimeve për një nxënës individualisht, lidhur me produktet dhe shërbimet veçmas të cilat financohen me para nga prindërit (ushqim, shërbimi i rojës shkollor, sigurimi i nxënësve, ekskursione, shërbime fotografimi etj.), shkolla zbaton vetëm një prokurim për shërbime fotografimi dhe një prokurim për ekskursion shkencor rekreativ për nxënësit e vitit të tretë dhe prindërit e bëjnë pagesën drejtpërdrejtë tek dhënësit e shërbimeve, jo në llogarinë e shkollës. Për vitin shkollor 2022/23, prindërit e fëmijëve kanë paguar 1,350 denarë për një nxënës për shërbime fotografimi në **‘Photo Violeta’** Strumicë. Për ekskursion, prindërit kanë paguar 20,999 denarë veçmas për një nxënës në Agjencinë Turistike **‘Atlantis’** Strumicë. Në lidhje me organizimin e mbrëmjes së maturës, nxënësit vetë angazhojnë një restorant, kurse shkolla nuk ka evidencë për harxhimet. Nuk na është dërguar shuma totale e parave që i ka mbledhur shkolla.

Sa i përket pyetjes nëse prokurimet për produkte dhe shërbime të financuara me paratë e prindërve të nxënësve janë zbatuar në bazë të akteve të brendshme të miratuara, nga drejtoria shkolla thonë se procedura për ekskursion realizohet në përputhje me Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollorë për nxënësit e shkollave të mesme nr. 07-9992/3 nga data 05.06.2014, e miratuar nga Ministria për Arsim dhe Shkencë. Në lidhje me procedurën e përzgjedhjes së ofertuesve më të favorshëm për fotografimin e nxënësve, shkolla i respekton udhëzimet e BPP-së që prokurimet që janë realizuar nga nxënësit nuk paraqesin prokurime publike dhe që shkolla vetëm formon një komision për mbledhjen dhe hapjen e ofertave dhe përzgjedhjen e ofertuesve më të favorshëm, kurse pagesa bëhet drejtpërdrejtë në llogarinë e ofertuesit të përzgjedhur. Për këto arsye të prezantuara, shkolla nuk i publikon informacionet e këtilla në ueb faqen e vet.

Sipas të dhënave dhe marrëveshjeve që janë dorëzuar me kohë nga SHMK **“Nikola Karev” Strumicë**, kemi gjetur informacionet se në këtë shkollë, në vitin 2022/2023 janë regjistruar 1,063 nxënës. Ndërsa i vetmi shërbim për të cilin prindërit e nxënësve në këtë shkollë i ndajnë mjetet e tyre është sigurimi i nxënësve. Shuma totale e mbledhur për sigurimin e nxënësve është 103,500 denarë. Çmimi individual për sigurim të nxënësve është 100 denarë. Sa i përket pyetjes nëse prokurimet për produkte dhe shërbime të financuara me para nga prindërit janë zbatuar në bazë të akteve të brendshme të miratuara, nga shkolla thonë që nuk ka prokurime të tilla, pra, si rrjedhojë nuk ka akte të brendshme dhe ato nuk janë të publikuara në ueb faqen e shkollës.

SHMKSHN **“Dimitar Vllahov” Strumicë**, në vitin shkollor 2022/23 janë regjistruar 705 nxënës. Sa i përket pyetjes për numrin e shërbimeve që financohen me paratë e prindërve, ato janë: ekskursioni për nxënësit e viteve të treta, tablo për maturë dhe mbrëmja e maturës. Ekskursioni për nxënësit e viteve të treta ka kushtuar në shumë totale prej 1,940,400 denarë, përkatësisht nga 18,480 denarë për një nxënës, për

tablonë e maturës 237,600 denarë përkatësisht nga 1,350 për një nxënës, ndërsa mbrëmja e maturës nga 1,500 për një nxënës, përkatësisht në shumë totale prej 267,000 denarë. Lidhur me pyetjen nëse prokurimet për produkte dhe shërbime të financuara me para nga prindërit janë zbatuar në bazë të akteve të brendshme të miratuara që na u dërguan në shtojcë të përgjigjes, por nuk publikohen në faqen e shkollës.



MULTIKULTURA

Hulumtim mbi mënyrën
e zbatimit të prokurimeve
që financohen me para prej
prindërve të nxënësve në
shkollat e Komunës së Tetovës



TË DHËNAT PËR SHKOLLAT NGA KOMUNA E TETOVËS

- Produktet dhe shërbimet që shkollat i sigurojnë me mjetet nga prindërit janë të ndryshme, edhe atë: sigurim i nxënësve, fotografim për tablo, fotografi grupi në fund të vitit shkollor, ekskursione dhe uniforma.
- Sigurimi personal i nxënësve është shërbim që e paguajnë të gjitha shkollat dhe çmimi për këtë shërbim është identik, përkatësisht nga 100 denarë për një nxënës.
- Çmimi për fotografi grupi në fund të vitit shkollor lëviz mes shumë 50 dhe deri 80 denarë.
- Për ekskursione, shuma për një nxënës varet nga distanca e udhëtimit.
- Duke e pasur parasysh që shërbimet dhe produktet e siguruar nga shkollat janë të ndryshme, ndërkaq edhe numri i nxënësve në secilën prej shkollave është i ndryshëm, edhe shuma e totalit të mjeteve financiare të mbledhura prej prindërve të nxënësve është e ndryshe. Domethënë, më së shumti mjete janë mbledhur prej prindërve në SHKME "8 Shtatori" në bazën për ekskursione për nxënësit, edhe atë nga 17,900 denarë për një nxënës (që e ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase) për vitin e tretë dhe në SHMKP "Gjoco Stojcevski", në të cilën është shuma totale e mjeteve financiare për nxënësit e viteve të III-ta dhe viteve të IV-ta është rreth 13,000 denarë, kurse më së paku në shkollat që mbledhin mjete prej prindërve të nxënësve vetëm në bazën për sigurimin e nxënësve, shërbim i cili kushton 100 denarë për një nxënës.
- Sipas të dhënave të shkollave të mesme, ato nuk kanë akte të brendshme, por për ekskursione i referohen Rregullores për organizimin e ekskursioneve. SHPSH QRATP "Mosha Pijade" nuk mbledh fare mjete prej prindërve.
- Nga gjithsej 18 shkolla në territorin e Komunës së Tetovës, vetëm dy (Gjimnazi "7 Marsi" dhe SHKME "8 Shtatori") i kanë dërguar të gjitha informacionet e kërkuara.
- Nga të dhënat që i kemi fituar nga shkollat fillore, ato sugjerojnë që prokurimet zbatohen me akte të brendshme, ato akte nuk janë të publikuara në ueb faqet e shkollave. Në SHFK "Cirili dhe Metodij" çdo prokurim për çdo shërbim është i përfshirë në ndonjë akt të brendshëm që është miratuar nga Këshilli i prindërve.

HULUMTIM I DETAJUAR

Në territorin e Komunës së Tetovës procesi arsimor zhvillohet në kuadër të 12 shkollave fillore dhe 6 shkollave të mesme.

Prezantimi tabelor i shkollave, numri i nxënësve dhe shpenzimet e përgjithshme të financuara nga prindërit e nxënësve

Emri i shkollës (fillore dhe	Numri i përgjithshëm i nxënësve	Çmimi për një nxënës në denarë
SHFK "Istikball"	1,050	670
SHF "Besa"	26	0
SHF "Goce Dellçev"	606	0
SHFK "Bratsvo Migjeni"	1,734	100
SHFK "Andrej Saveski Qiqish"	265	0
SHFK "Cirili dhe Metodij"	1,037	300
SHFK "Rexhep Voka"	236	1,580
SHSHM "Todor Skalovski – Tetoec"	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara	
SHFK "Rilindja"	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara	
SHFK "Përparimi"	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara	
SHFK "Naim Frashëri"	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara	
SHFK "Liria"	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara	
SHFK "Gjerg Kastriot Skenderbeu"	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara	
SHMK Gjimnazi "Kiril Pejçinovic"	Nuk i dërguan informacionet e kërkuara	
SHMK "7 Marsi"	522	9,900
SHMKM "Nikola Stein"	2,121	1,500
SHMKP "Gjoce Stojçevski"	592	3,000 - 13,000
SHMKE "8 Shtatori"	1,176	10,700 - 17,900

SHSHM "Todor Skalovski – Tetoec", SHFK "Rilindja", SHFK "Përparimi", SHFK "Naim Frashëri", SHFK "Liria", SHFK "Gjerg Kastriot Skenderbeu" dhe SHMK Gimnazi "Kiril Pejçinovic" nuk kanë i dërguar informacionet e kërkuara në lidhje me mjetet që janë mbledhur prej prindërve të nxënësve.

SHKOLLAT FILLORE

Në shkollën fillore **“Istikbal”** në Tetovë mësojnë gjithsej 1050 nxënës. Sipas përgjigjeve që i fituam lidhur me kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, shkolla mbledh para prej prindërve për: sigurimin e nxënësve, ekskursionet dhe fotografim në grup.

Tabela nr. 1 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHF “Istikbal”, Tetovë

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi i nxënësve	nuk e kanë dërguar informacionin e kërkuar	100 denarë
Ekskursion	nuk e kanë dërguar informacionin e kërkuar	300 - 500 denarë
Foto në grup	nuk e kanë dërguar informacionin e kërkuar	70 denarë

Sipas përgjigjes që e fituam nga shkolla, shërbimet e financuara nga paratë e prindërve të nxënësve realizohen me akte të brendshme. Edhe pse faqja e internetit është aktive, aktet e brendshme nuk publikohen aty.

Në shkollën fillore **“Besa”** mësojnë gjithsej 26 nxënës. Sipas përgjigjes që e fituam nga shkolla, produktet dhe shërbimet që financohen me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve janë sigurimet e nxënësve dhe ekskursionet. Paratë për këto dy shërbime janë realizuar përmes arsimtarëve-kujdestarë të klasës. Nga shkolla nuk kanë dërguar informacione për shpenzimet e përgjithshme të një nxënësi për këto shërbime as informacione nëse ka akte të brendshme nënligjore për zbatimin e këtyre prokurimeve.

Në shkollën fillore **“Goce Dellçev”** mësojnë 606 nxënës. Sipas përgjigjes që e fituam nga shkolla, produkte dhe shërbime nga paratë e mbledhura prej prindërve nuk prokurohen.

Në shkollën fillore **“Bratsvo Migjeni”** numri i përgjithshëm i nxënësve në vitin shkollor 2022/2023 ishte 1,734 nxënës.

Prej prindërve mblidhen vetëm paratë për sigurimin e nxënësve dhe kjo bëhet në bazë vullnetare.

Prokurimet e zbatuara për produkte dhe shërbime të financuara me para prej prindërve të nxënësve janë në bazë të akteve të brendshme të miratuara, por këto akte nuk publikohen në faqen e internetit të shkollës.

Tabela nr. 2 – Shërbimet, çmimi për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHFK “Bratsvo Migjeni”, Tetovë

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi i nxënësve	67.500	100

Në shkollën fillore **“Andrej Saveski Qiqish”** mësojnë 265 nxënës.

Sipas përgjigjes që e fituam nga shkolla, nuk ka listë të produkteve dhe shërbimeve që financohen në shkollë me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve, sepse shkolla nuk mbledh para prej prindërve të nxënësve.

Në shkollën fillore **“Cirili dhe Metodij”** mësojnë 1,037 nxënës.

Shërbimet që financohen nga prindërit e nxënësve janë: Sigurimi, transporti për ekskursionin dhe fotografimi në grup.

Shkolla nuk ka dërguar informacione për numrin e përgjithshëm të nxënësve që i kanë përdorur këto shërbime.

Çdo prokurim për çfarëdo shërbimi, nga shkolla pohojnë se është i mbuluar me ndonjë dokument i cili është lëshuar nga Këshilli i prindërve.

Tabela nr. 3 – Shërbimet, çmimi për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHFK "Cirili dhe Metodij", Tetovë

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi i nxënësve	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	100 denarë
Transport për ekskursion	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	150 denarë
Fotografim	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	50 denarë

Në shkollën fillore "Rexhep Voka", mësojnë 236 nxënës.

Prej prindërve të nxënësve janë mbledhur para për shërbimet si më poshtë: sigurimi i nxënësve, ekskursion, fotografim për nxënësit në klasën I (e parë) deri në klasën IX (e nëntë) dhe fotografim për tablo për nxënësit e klasave të nënta.

Për shërbimin e sigurimit të nxënësve, prindërit paguajnë nga 100 denarë për çdo nxënës dhe gjithsej 225 nxënës janë siguruar.

Tabela nr. 4 – Shërbimet, çmimi për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHFK "Rexhep Voka", Tetovë

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi i nxënësve	22,500 denarë	100 denarë
Ekskursion	64,240 denarë	880 denarë
Foto në grup		80 denarë
Fotografim për tablo	28,400 denarë	600 denarë

Shkolla nuk dërgoi informacione për aktet e brendshme, por vetëm informacion se ekskursionet realizohen në bazë të Rregullores për realizimin e ekskursioneve të nxënësit të të miratuar nga Ministria për Arsim dhe Shkencë.

SHKOLLAT E MESME

Në komunën e Tetovës nxënësit mësojnë në shkollat e mesme si në vijim::

- SHMK "Kirill Pejçinoviç"
- SHMK "7 Marsi"
- SHMKM "Nikola Stejn"
- SHMKE "8 Shtatori"
- SHMKP "Moshë Pijade"
- SHMKT "Gjoce Stojçeski"
- SHSHM "Todor Skalovski – Tetoec"

Informacione për produktet dhe shërbimet e financuara me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve nuk janë dërguar nga SHKM Gjimnazi "Kirill Pejçinoviç" dhe SHSHM "Todor Skalovski – Tetoec".

Në SHMK "7 Marsi" mësojnë gjithsej 522 nxënës. Sipas përgjigjes lidhur me kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, shërbimet që planifikohen të realizohen me mjetet që janë mbledhur prej prindërve të nxënësve janë ekskursionet shkollore, sigurimet e nxënësve dhe fotografimi i nxënësve në grup.

Gjatë vitit 2022/2023, SHMK Gjimnazi "7 Marsi" ka realizuar një ekskursion të fundit në Shqipëri, në të cilin kanë marrë pjesë 105 nxënës dhe çmimi për një nxënës ka qenë 9840,00 denarë. Sikur edhe në shkollat tjera, edhe në këtë shkollë të mesme ekskursionet realizohen në bazë të Rregullores për organizim të ekskursioneve.

Për sigurimin e nxënësve, shërbim i cili është në bazë vullnetare, nëpërmjet kujdestarëve të klasave janë mbledhur nga 100,00 denarë për çdo nxënës.

Prindërit kanë qenë të informuar nëpërmjet arsimtarëve-kujdestarë të klasave për të gjitha shërbimet që janë realizuar me mjetet nga prindërit e nxënësve.

Sipas përgjigjes për kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, momentalisht për shkak të problemeve teknike me ueb faqen e shkollës, këto informacione nuk janë publikuar.

Tabela nr. 5 – Mjete të mbledhura prej prindërve për aktivitete jashtëshkollore në SHKM Gjimnazi "7 Marsi" - Tetovë

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Ekskursion në Shqipëri	1,033,200 denarë	9,840 denarë
Sigurimi i nxënësve	51,500 denarë	100 denarë
Shuma totale	1,084,700 denarë	

SHMKM "Nikola Stejn" në vitin shkollor 2022/23 procesin mësimor e ka realizuar për gjithsej 2,121 nxënës. Sipas përgjigjes për kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, shkolla e organizon sigurimin e produkteve dhe shërbimeve të financuara nga prindërit e nxënësve edhe atë: sigurimet e nxënësve, ekskursionet, matura, fotografimi dhe uniformat e nxënësve.

Mbajtja e uniformës është paraparë me rendin shtëpiak të SHMKM “Nikola Stejn” dhe Kodin e sjelljes së nxënësve.

Nga paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve realizohen dy ekskursionë nga 600 denarë, të cilat realizohen në përputhje me Rregulloren për organizimin e ekskursioneve e cila është miratuar nga Ministria për Arsim dhe Kulturë dhe në përputhje me Programin Vjetor për realizimin e ekskursioneve të miratuara nga BZHA dhe nga Bordi i Drejtorëve.

Sipas përgjigjes për kërkesën për qasje tek informacionet me karakter publik, aktet e brendshme nuk publikohen në ueb faqen e shkollës, por prindërit informohen për të gjitha produktet dhe shërbimet dhe japin pëlqimin e tyre në mbledhjet e këshillit të prindërve.

Tabela nr. 6 – Mjete të mbledhura prej prindërve të nxënësve për aktivitete jashtëshkollore në SHMKM “Nikola Stejn” - Tetovë

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	100 denarë
Dy ekskursionë	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	1200 denarë
Uniforma e nxënësve të vitit të parë	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	600 denarë
Uniformë e nxënësve për praktikë	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	600 denarë
Fotografim		50 denarë

Në SHMKP “Gjoce Stojčevski” numri i përgjithshëm i nxënësve për vitin shkollor 2022/2023 ka qenë 592.

Në vitin shkollor 2022/2023, prindërit e nxënësve i kanë financuar këto shërbime: sigurimin e nxënësve, realizimin e ekskursioneve njëditore për nxënësit e viteve I, II, III dhe IV në relacionet Tetovë-Ohër-Strugë-Tetovë dhe në relacionet Tetovë-Kodra e Diellit-Tetovë, ekskursion pesëditor në Shqipëri për nxënësit e vitit të III-të, fotografimi i klasës dhe fotografim i maturantëve si dhe organizimi i mbrëmjes së maturës.

Shuma totale e mjeteve financiare për një nxënës është rreth 3,000 denarë, ndërsa për nxënësit e vitit të III dhe të IV rreth 13,000 denarë.

Prokurimet e zbatuara në këtë shkollë janë realizuar nëpërmjet publikimit të shpalljeve publike për mbledhje të ofertave. Shpalljet publike për mbledhjen e ofertave publikohen të paktën në dy gazeta ditore.

Tabela nr. 7 – Mjete të mbledhura prej prindërve të nxënësve për aktivitete jashtëshkollore në SHMKP “Gjoce Stojçeovski” - Tetovë

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës individualisht në denarë
Sigurimi i nxënësve	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	100 denarë
Ekskursion në linjën Tetovë-Ohër-Strugë-Tetovë	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	700 denarë
Ekskursion në linjën Tetovë-Kodra e Diellit-Tetovë	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	420 denarë
Ekskursion pesëditor në Shqipëri (nxënësit e vitit të tretë)	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	9.900 denarë
Fotografi në grup	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	70 denarë

Në SHMKE “8 Shtatori” në Tetovë, numri i nxënësve në vitin shkollor 2022/2023 ka qenë 1,176 nxënës.

Në këtë shkollë realizohen ekskursionet në bazë të Rregullores për realizimin e ekskursioneve shkollore në shkollat e mesme, në përputhje me programin vjetor dhe në bazë të njoftimit të publikuar për realizimin e ekskursioneve. Shkolla pranon oferta dhe komisioni për shqyrtimin e ofertave jep propozim për ofertën më të favorshme, çmimi më i ulët është kushti i përzgjedhjes. Shkolla nuk mbledh para për realizimin e ekskursionit, por prindërit e bëjnë pagesën drejtpërdrejtë në Agjencinë Turistike. Shkolla lidh marrëveshje me AT-në e përzgjedhur, duke i respektuar dispozitat e Rregullores për realizimin e ekskursioneve shkollore në shkollat e mesme.

Gjithashtu, nxënësit mund të sigurojnë veten për 100 denarë për sipas dëshirës dhe ajo shumë paguhet në llogarinë e kompanisë së sigurimit. Gjithashtu, shkolla nuk lidh kontrata për shërbime fotografimi, nxënësit vetë përzgjedhin një foto-studio dhe drejtpërdrejtë e paguajnë shumën për çmimin e përcaktuar me marrëveshje për shërbimin e realizuar.

Tabela nr. 8 - Mjete të mbledhura prej prindërve të nxënësve për aktivitete jashtëshkollore në SHMKE “8 Shtatori” - Tetovë

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Ekskursion në Republikën e Italisë, Republikën e Sllovenisë dhe Republikën e Serbisë	1,108,800 denarë	16,800 denarë
Ekskursion në R. Shqipëri	1,123,200 denarë	9,600 denarë
Ekskursion në Ohër	434,000 denarë	700 denarë
Ekskursion në Kodrën e Diellit	224,400 denarë	300 denarë
Sigurimi i nxënësve	100,600 denarë	100 denarë
Shuma totale	2,991,000 denarë	

Hulumtim mbi mënyrën e
zbatimit të prokurimeve që
financohen me para prej
prindërve të nxënësve në
shkollat e Komunës së Çairit



TË DHËNAT PËR SHKOLLAT NGA KOMUNA E ÇAIRIT

- Shumica e shkollave të përfshira në këtë hulumtim nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara. Të dhëna kemi fituar vetëm nga shkollat fillore “Hasan Prishtina” dhe “Jashar Bej Shkupi”.
- Të gjitha shkollat e përfshira në hulumtim nuk kanë akte të brendshme të publikuara në bazë të të cilave janë zbatuar prokurimet për produkte dhe shërbime të financuara me paratë e prindërve të nxënësve. Disa shkolla nuk kanë as ueb faqen e tyre.
- Disa nga shkollat i kanë publikuar planet vjetore, në të cilat janë planifikuar ekskursione, por mënyra e financimit të tyre nuk është specifikuar.
- Shkolla e mesme “Cvetan Dimov” ka publikuar një raport vjetor për punën e shkollës për vitin shkollor 2022/2023, në të cilin është cekur që bordi i shkollës formon Komision për mbledhjen e ofertave për ekskursione, por nuk janë paraqitur shpenzimet dhe prokurimet për produkte dhe shërbime që financohen me para nga prindërit.

HULUMTIM I DETAJUAR

Me këtë hulumtim janë përfshirë dhjetë shkolla fillore dhe një shkollë e mesme në komunën e Çairit. Kërkesa për qasje tek informacionet me karakter publik është dërguar në tetor të vitit 2023, me të cilën janë kërkuar detaje për numrin e nxënësve, produktet dhe shërbimet e financuara, shpenzimet e përgjithshme, shpenzimet individuale për një nxënës, aktet e brendshme dhe publikim i këtyre akteve në ueb - faqet e shkollave.

Tabela 1 - Shërbimet, çmimet për çdo shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në shkollat në Komunën e Çairit

Shkollat në Komunën e Çairit	Lista e produkteve dhe shërbimeve që financohen në shkollë me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve në vitin shkollor 2022/2023	Shuma totale e mjeteve financiare të shpenzuara në nivel të listës së produkteve dhe shërbimeve	Shpenzimet në bazë individuale për çdo nxënës në lidhje me produktet dhe shërbimet konkrete që financohen me para nga prindërit	Nëse prokurimet e zbatuara për produkte dhe shërbime me para nga prindërit janë në bazë të akteve të brendshme të miratuara	A publikohen në ueb faqen e shkollës aktet e brendshme për prokurim të produkteve dhe shërbimeve që financohen me para nga prindërit
SHF "Liria"	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara
SHF "Tefejuz"	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara
SHF "Hasan Prishtina"	Ushqim për nxënësit në qëndrim tërë-ditor, ekskursione dhe piknik, sigurim i nxënësve dhe fotografim	10,928 denarë	Çmimi individual për ushqim për nxënësit në qëndrim tërë-ditor: 2,200 denarë Çmimi për piknik-Saraj: 219 denarë Çmimi për ekskursion njëditor: 790 denarë Çmimi për ekskursion dyditor: 3,270 denarë Çmimi për ekskursion treditor: 4,299 denarë Çmimi për sigurimin e nxënësve: 100 denarë Çmimi për fotografi: 50 denarë	Për ushqimin e nxënësve, shkolla ka lidhur kontratë për qiramarrje me kompaninë "Te Baba Rexh" dhe pastaj kompania dhe prindërit lidhin një marrëveshje të brendshme për ushqimin e nxënësve; Për ekskursionet është publikuar shpallje publike; Është lidhur një kontratë sigurimi me një kompani sigurimi; Për fotografim janë dërguar oferta nga 3 kompani dhe komisioni për prokurime publike ka përzgjedhur ofertën më të favorshme	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara

SHF A. S. Makarenko	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara
SHF Vasil Glavinov	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara
Kongreset dhe Manastiri i SHF	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara
SHF "Ismail Qemali"	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara
SHF "7 Marsi"	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara
SHF "Imri Elezi"	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara
SHF "Jashar Bej Shkupi"	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	6,000 denarë	13 denarë për foto	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara
SHF "Cvetan Dimov"	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara	nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara

Tabela 2 – Numri i përgjithshëm i nxënësve në vitin shkollor 2022/2023

Emri i shkollave fillore dhe shkollave të mesme	Numri i përgjithshëm i nxënësve në vitin shkollor 2022/2023
SHF "Liria"	895
SHF "Tefejuz"	1,059
SHF "Hasan Prishtina"	1,127
SHF "A. S. Makarenko"	278
SHF "Vasill Gllavinov"	869
SHF "Kongresi i Manastirit"	622
SHF "Ismail Qemali"	1,537
SHF "7 Marsi"	998
SHF "Imri Elezi"	851
SHF "Jashar Bej Shkupi"	464
SHM "Cvetan Dimov"	1,174

Shkolla fillore "Hasan Prishtina" na siguroi informacione të detajuara për shërbimet e financuara: ushqim, ekskursionet, sigurim i nxënësve dhe shërbime për fotografim. Shkolla është përfshirë në një proces transparent të përzgjedhjes së ofruesve të shërbimeve nëpërmjet shpalljeve publike dhe ofertave konkurruese.

Sipas informacioneve të dërguara nga shkolla fillore, varësisht se në cilën klasë është nxënësi, shpenzimet janë si vijon:

- Për piknik në Saraj për nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, shpenzimet janë 219 denarë për një nxënës dhe ato i realizon kompania Dema Travel;
- Për një ekskursion njëditor për nxënësit e klasës së tretë shpenzimet janë 790 denarë për një nxënës dhe ekskursionin e realizon kompania Vista Turs;
- Për një ekskursion dyditor për nxënësit e klasës së gjashtë, shpenzimet arrijnë shumën prej 3,270 denarë për nxënës dhe ato i realizon kompania Dema Travel;
- Për një ekskursion treditor për nxënësit e klasës së nëntë, shpenzimet janë 4,299 denarë për një nxënës dhe ato realizohen nga kompania Dema Travel;
- Për sigurimin e nxënësve, çmimi është 100 denarë për një nxënës dhe shërbimin e ofron kompania "Eurolink";
- Për fotografim, çmimi është 50 denarë për një nxënës dhe shërbimin e ofron foto-studio "Meko";
- Për shujtat për nxënësit në qëndrim tërë-ditor, individualisht çmimi është 2,200 denarë.

Sipas shkollës, për ekskursionin në vitin shkollor 2022-2023, shkolla ka publikuar një shpallje publike dhe sipas kriterit të çmimit më të ulët është përzgjedhur agjencia turistike që e ka realizuar ekskursionin. Shkolla ka lidhur kontratë për qiramarrje me kompaninë "Te Baba Rexh" dhe më pas kompania dhe prindërit e nxënësve lidhin marrëveshje të brendshme për ushqimin e nxënësve. Sa i përket sigurimit të nxënësve, shkolla ka lidhur marrëveshje me kompaninë e sigurimeve "Eurolink" me çmim prej 100 denarë për çdo nxënës dhe polica është dorëzuar. Për shërbimin e fotografimit të nxënësve, në shkollë janë dërguar oferta nga tre kompani dhe më pas komisioni për prokurime publike ka përzgjedhur ofertën më të favorshme.

Shkolla fillore "Jashar Bej Shkupi" ka dërguar informacione që shuma e përgjithshme e mjeteve financiare të shpenzuara për shërbimin për fotografim është 6,000 denarë. Ndërsa çmimi për një nxënës për shërbimin për fotografim, të financuar me para nga prindërit, është 13 denarë.

TRANSPARENCA:

Në lidhje me publikimin e dokumenteve, për prokurimet për nxënësit, në ueb faqet e shkollave të Komunës së Çairit:

- **Shkolla fillore "Liria"** nuk ka publikuar dokumente lidhur me prokurimet për nxënësit në ueb faqen e shkollës.
- **Shkolla fillore "Tefejuz"** nuk ka ueb faqen e shkollës.
- **Shkolla fillore "Hasan Prishtina"** nuk ka postuar dokumente lidhur me prokurimet për nxënësit në ueb faqen e shkollës. Shkolla ka publikuar një program vjetor për punën edukative-arsimore, i cili përfshin një plan të detajuar për realizimin e ekskursioneve, mësim në natyrë dhe ekskursione në vitin shkollor 2022/2023, por nuk specifikohet se si mbulohen këto shpenzime.
- **Shkolla fillore "A.S. Makarenko"** nuk ka publikuar dokumente lidhur me prokurimet për nxënësit në ueb faqen e shkollës.
- **Shkolla fillore "Vasill Gllavinov"** në programin vjetor për vitin shkollor 2021/2022, në mënyrë të detajuar i ka cekur ekskursionet e planifikuara dhe thekson që mënyra e financimit është me vetëfinancim nga prindërit e nxënësve në katër këste, përkatësisht prindërit e bëjnë pagesën nëpërmjet një fletëpagesë të cilën më pas ua tregojnë arsimtarëve-kujdestarë të klasës. Për financimin e shujtave, në raportin vjetor për vitin shkollor 2021/2022, është cekur se nxënësit që janë me qëndrim të zgjatur kanë një vakt të ngrohtë të organizuar në kuzhinën e shkollës, për të cilin mjetet financiare i sigurojnë prindërit.
- **Shkolla fillore "Kongresi dhe Manastirit"** nuk ka ueb faqen e vet.
- **Shkolla fillore "Ismail Qemali"** nuk ka publikuar dokumente lidhur me prokurimet për nxënësit në ueb faqen e shkollës.
- **Shkolla fillore "7 Marsi"** nuk ka ueb faqe.
- **Shkolla fillore "Imri Elezi"** nuk ka ueb faqe.
- **Shkolla fillore "Jashar Bej Shkupi"** nuk ka publikuar dokumente në lidhje me prokurimin e nxënësve në faqen e saj, por raportohet se janë bërë ekskursione.
- Në ueb faqen e vet, shkolla e mesme **"Cvetan Dimov"** ka publikuar raport vjetor për punën e shkollës për vitin shkollor 2022/2023, ku është cekur se bordi i shkollës formon Komision për grumbullimin e ofertave për ekskursione. Gjithashtu, në raportin shkruan që në kuadër të mjeteve financiare në dispozicion të siguruara nga Buxheti i RMV-së, si dhe mjetet e siguruara në bazë të të ardhurave vetanake të shkollës, janë zbatuar procedura për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve në drejtim të përmirësimit e kushteve materiale dhe teknike për punë dhe mësim, por nuk ka më tepër detaje. Në pjesën me burimet e financimit, në tekstin e raportit thuhet që mjetet për financimin e shkollës sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu thuhet se shkolla fiton mjete në bazë të të ardhurave vetanake nga dhënia e shërbimeve arsimore për kandidatë me korrespondencë, dhënie me qira të disa pjesëve të shkollës. Nuk janë cekur shpenzime dhe prokurime për produkte dhe shërbime që financohen me para nga prindërit.

Hulumtim mbi mënyrën
e zbatimit të prokurimeve
që financohen me para
prej prindërve të nxënësve në
shkollat e Komunës së Shtipit



TË DHËNAT PËR SHKOLLAT NGA KOMUNA SHTIP

- Produktet dhe shërbimet që shkollat i sigurojnë me mjete nga prindërit janë të ndryshme, edhe atë: sigurimi personal i nxënësve, fotografimi për tablo, fotografimi në grup në fund të vitit shkollor, ekskursionet, festat e semi-maturës dhe të maturës, si dhe prokurimi i uniformave, që si shërbim është vërejtur vetëm në një shkollë të mesme në këtë komunë.
- Sigurimi personal i nxënësve është shërbim që sigurojnë të gjitha shkollat dhe çmimi për këtë shërbim është i njëjtë, përkatësisht 100 denarë për një nxënës. Fotografia për tablo dallon nga 950 denarë deri në 1,100 denarë për një nxënës. Për ekskursionet në shkollat fillore, shuma për një nxënës lëviz nga 440 denarë e deri në 5,500 denarë, varësisht nga distanca dhe itinerari i ekskursionit, ndërsa për shkollat e mesme, shuma për një nxënës lëviz nga 550 denarë e deri në 16,800 denarë.
- Duke e pasur parasysh që shërbimet dhe produktet e prokuruar nga shkollat janë të ndryshme, ndërsa edhe numri i nxënësve në secilën prej shkollave është i ndryshëm, edhe shuma e totalit të mjeteve financiare të mbledhura prej prindërve të nxënësve është ndryshe. Domethënë, shuma më e madhe e mjeteve që janë mbledhur prej prindërve ka qenë në shkollën fillore komunale “Vanço Përçe”, edhe atë gjithsej 2,843,610 denarë, më së shumti në gjeneratat e klasave të nënta, gjithsej 14.800 për një nxënës. Në grupin e shkollave të mesme, më së shumti mjete janë mbledhur prej prindërve të nxënësve në shkollën e mesme komunale “Jane Sandanski” edhe atë 3,785,800 denarë në bazën për ekskursionet për nxënësit e vitit të tretë edhe atë 15,850 denarë individualisht, ndërsa më së paku në shkollën “Dimitar Murasçiev”, ku janë mbledhur gjithsej 38,750 denarë.
- Disa nga shkollat nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara për produktet dhe shërbimet që prokurohen me mjete financiare nga prindërit dhe vlerën e tyre, me arsyetimin që këshillat e prindërve i kanë ato informacione. Qëndrimet e tilla flasin pa mëdyshje për vetëdijen e ulët që ekziston në shkollat lidhur me nevojën për t’u garantuar transparencë, llogaridhënie dhe integritet në këto procedura. Përndryshe, ekziston rrezik nga korrupsioni në to.
- Asnjë nga shkollat fillore dhe të mesme nuk ka akte të brendshme për zbatimin e prokurimeve që financohen me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve. Në bazë të procedurave të përcaktuara qartë, zbatohen vetëm procedurat për përzgjedhjen e agjencive turistike për realizimin e ekskursioneve dhe aktiviteteve tjera jashtëshkollore që realizohen në përputhje me rregulloret për këtë dedikim, e të cilat janë miratuar nga Ministria për Arsim dhe Shkencë.
- Një praktikë e mirë është vërejtur në SHMK “Kole Nehtenin”, ku prokurimet e zbatuara për shërbime, të financuara me para nga prindërit janë zbatuar në bazë të Statutit të shkollës. Këshilli i prindërve merr vendime për fotografim dhe sigurimin e nxënësve, ndërsa Këshilli i shkollës merr vendime për ekskursionet e nxënësve.

- Edhe pse shkollat fillore dhe shkollat e mesme në territorin e komunës së Shtipit kanë ueb-faqe aktive, (me përjashtim të SHFK "Sllavejko Arsov"), Rregullorja e Ministrisë për Arsim dhe Shkencë për organizimin e ekskursioneve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore nuk është e publikuar në faqet e internetit të shkollave. Përjashtim është SHMK "Kole Nehtenin", ueb faqja e së cilës i përmban të gjitha informacionet e nevojshme për funksionimin e shkollës, si dhe një link në ueb faqen e Ministrisë për Arsim dhe Shkencë, në të cilin mund të gjeni Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore për shkollat e mesme.
- Të dhënat që përmban ky hulumtim janë siguruar në bazë të parashtrimit të kërkesave për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik dhe janë përgjegjësi e personave që punojnë në institucionet arsimore dhe të cilët u përgjigjen në kërkesat e parashtruara. Përgjithësisht na janë dërguar informacione në bazë të këtyre kërkesave, megjithatë në shumicën e shkollave është dërguar kërkesë për plotësim të përgjigjeve, disa u përgjigjën me e-mail, jo në formë të përgjigjes ndaj kërkesës dhe formularit, që është një tregues se institucionet arsimore ende nuk janë mjaft serioze dhe veprojnë në mënyrë të kundërligjshme për sa i përket Ligjit për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik. Gjithashtu, përgjigjet jo të plota që na janë dërguar mund të interpretohen si tregues për diçka që duan ta fshehin, që sugjeron në indicie për korrupsion.

HULUMTIM I DETAJUAR

Në vitin shkollor 2022/2023, në territorin e Komunës së Shtipit procesi arsimor është zhvilluar në 5 shkolla fillore komunale me gjithsej 3,627 nxënës të regjistruar si të rregullt dhe 6 shkolla të mesme me 2,159 nxënës të regjistruar si nxënës të rregullt. Në vitin shkollor 2022/2023, në shkollat fillore në Shtip, sipas të dhënave që na janë dërguar për kërkesat e parashtruara për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, nga prindërit e nxënësve janë mbledhur gjithsej 7,273,790 denarë për prokurime për produkte dhe shërbime të ndryshme siç është fotografimi, sigurimi i nxënësve, organizimi i ekskursioneve etj.

Tabela nr. 1. Numri i nxënësve dhe shpenzimet e përgjithshme të financuara nga prindërit e nxënësve

Emri i shkollës (fillore dhe të mesme)	Numri i përgjithshëm i nxënësve	Vlera totale për të gjitha shërbimet në denarë
SHF "Vanço Përçe"	1,219	2,843,610
SHF "Dimitar Vllahov"	875	1,475,170
SHF "Tosho Arsov"	557	1,253,940
SHF "Goce Dellçev"	660	1,083,800
SHF "Slavejko Arsov"	318	617,270
SHMK "Slavço Stojmenski"	520	779,520
SHMK "Jane Sandanski"	656	3,785,800
SHMK "Kole Nekhtenin"	691	2,303,650
SHMK "Dimitar Mirashchiev"	94	38,750
SHMSH "Sergei Mihailov"	144	49,200
SHMSH "Iskra"	52	Prokurimet nuk financohen me para nga prindërit

SHKOLLAT FILLORE

Në shkollën fillore "Vanço Përçe" në Shtip mësojnë gjithsej 1,249 nxënës. Në bazë të përgjigjes nga shkolla, ajo me paratë e prindërve siguron disa lloje shërbimesh edhe atë:

- » Ushqim për nxënësit;
- » Sigurimi i nxënësve;
- » Shërbime fotografimi;
- » Ekskursionet dhe aktivitete jashtëshkollore;
- » Festa e semi-maturës;

Mjetet financiare për produktet dhe shërbimet e financuara nga prindërit paguhen drejtpërdrejt nga prindërit në llogarinë e ofertuesit të përzgjedhur dhe shkolla nuk ka të dhëna të drejtpërdrejta lidhur me to. Përgjigja e tillë flet për vetëdijen e ulët që ekziston në shkollë në lidhje me nevojën për t'u siguruar të transparencë dhe përgjegjësi në këto procedura.

Tabela nr. 2 – Shërbimet, çmimet për çdo shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHF “Vanço Përçe”, Shtip

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi i nxënësve	115,000 denarë	100 denarë
Ushqimi	749,100 denarë	1,100 denarë
Foto në grup	94,600 denarë	100 denarë
Foto individuale - klasat e para	19,950 denarë	150 denarë
Foto individuale – klasat e 5-ta	45,200 denarë	400 denarë
Fotografi për almanak	109,250 denarë	950 denarë
Festa e gjysmë maturës	79,350 denarë	690 denarë
Piknik ditor në vjeshtë	272,690 denarë	370 denarë
Piknik ditor pranveror	146,640 denarë	240 denarë
Mësimdhënie në natyrë	469,730 denarë	4,390 denarë
Ekskursion dyditor	288,900 denarë	2,889 denarë
Ekskursion tre ditor	453,200 denarë	4,400 denarë
Gjithsej	2,843,610 denarë	

Në SHMK “Dimitar Vllahov” në vitin shkollo 2022/23, mësimin e kanë ndjekur gjithsej 873 nxënës. Sipas përgjigjes nga shkolla, me paratë e prindërve shkolla siguron disa lloje shërbimesh edhe atë:

- » Ushqim për nxënësit;
- » Sigurimi i nxënësve;
- » Shërbime fotografimi;
- » Ekskursion dhe aktivitete jashtëshkollore;

Tabela nr. 3 - Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHF “Dimitar Vllahov”

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi i nxënësve	87,300 denarë	100 denarë
Ushqimi	1,431,000 denarë	900 denarë
Foto në grup	87,300 denarë	100 denarë
Foto individuale - klasat e para	14,850 denarë	150 denarë
Foto individuale – klasat e 5-ta	48,400 denarë	400 denarë
Fotografim për semi-maturë	84,000 denarë	1,050 denarë
Piknik pranveror ditor në Piperovo	126,000 denarë	300 denarë
Piknik pranveror ditor në Brest	85,200 denarë	300 denarë
Ekskursion një ditor	56,160 denarë	540 denarë
Mësimdhënia në natyrë	307,200 denarë	3,840 denarë
Ekskursion dyditor	131,580 denarë	2,580 denarë
Ekskursion tre ditor	295,680 denarë	3,840 denarë
Gjithsej	2,754,670 denarë	

Në SHFK "Tosho Arsov" në vitin shkollor 2022/23 mësimin e kanë ndjekur gjithsej 557 nxënës. Sipas përgjigjes nga shkolla, me paratë e prindërve shkolla siguron disa lloje shërbimesh edhe atë:

- » Ushqim për nxënësit;
- » Sigurimi i nxënësve;
- » Ekskursion dhe aktivitete jashtëshkollore;

Tabela nr. 4 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHF "Tosho Arsov"

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi i nxënësve	50,000 denarë	100 denarë
Ushqimi	164,350 denarë	950 denarë
Piknik ditor pranveror	136,760 denarë	260 denarë
Ekskursion njëditor	36,570 denarë	690 denarë
Mësimdhënie në natyrë	316,680 denarë	5,460 denarë
Ekskursion dyditor	164,920 denarë	2,660 denarë
Ekskursion tre ditor	387,660 denarë	5,460 denarë
Gjithsej	1,256,940 denarë	

Në SHFK "Goce Dellçev", në vitin shkollor 2022/23 mësimin e kanë ndjekur gjithsej 660 nxënës. Sipas përgjigjes nga shkolla, me paratë e prindërve shkolla siguron disa lloje shërbimesh edhe atë:

- » Ushqim për nxënësit;
- » Sigurimi i nxënësve;
- » Ndarje
- » Shërbime fotografimi;
- » Ekskursion dhe aktivitete jashtëshkollore;

Tabela nr. 5 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHF "Goce Dellçev"

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi i nxënësve	47,100 denarë	100 denarë
Ushqimi	378,900 denarë	900 denarë
Foto në grup	60,100 denarë	100 denarë
Foto individuale – klasat e 5-ta	28,500 denarë	550 denarë
Fotografim për gjysmë maturë	60,900 denarë	1,050 denarë
Piknik ditor	98,560 denarë	320 denarë
Ekskursion një ditor	19,680 denarë	480 denarë
Mësimdhënie në natyrë	154,000 denarë	5,500 denarë
Ekskursion dyditor	80,360 denarë	1,960 denarë
Ekskursion tre ditor	216,600 denarë	5,700 denarë
Gjithsej	1,144,700 denarë	

Në shkollën fillore, SHFK "Sllavejko Arsov", në vitin 2022/2023 janë regjistruar gjithsej 318 nxënës. Produktet dhe shërbimet që financohen me mjete nga prindërit e nxënësve janë si vijon:

- » Sigurimi i nxënësve;
- » Ushqimi
- » Fotografim;
- » Dy piknikë dhe një ekskursion dyditor.

Tabela nr. 6 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve në SHF "Sllavejko Arsov"

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurimi i nxënësve	30,900 denarë	100 denarë
Ushqimi	135,000 denarë	900 denarë
Foto në grup	30,800 denarë	100 denarë
Foto individuale – klasat e 5-ta	15,400 denarë	550 denarë
Fotografim për gjysmë maturë	28,350 denarë	1,050 denarë
Piknik pranveror ditor në Lesново	22,000 denarë	200 denarë
Ponikva – njëditor	26,800 denarë	200 denarë
Ekskursion një ditor	//	500 denarë
Ekskursion dyditor	68,670 denarë	3,270 denarë
Ekskursion tre ditor	//	4,950 denarë
Gjithsej	357,920 denarë	

SHKOLLAT E MESME

Në komunën e Shtipit ka 4 shkolla të mesme komunale dhe 2 shkolla të mesme shtetërore. Të regjistruar janë gjithsej 2,157 nxënës, nga të cilët, në shkollat e mesme shtetërore të regjistruar janë 196, ndërsa në shkollat e mesme komunale 1,961 nxënës të rregullt.

Produktet dhe shërbimet që financohen në shkollat e mesme me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve në vitin shkollor 2022/2023 janë përgjithësisht: shërbimet për fotografim, sigurimet e nxënësve, ekskursionet, ekskursioni kërkimor profesional dhe matura.

Sipas të dhënave që na janë dërguar, nuk janë mbledhur para nga prindërit e nxënësve në shkollën e mesme shtetërore "Iskra".

SHMK Gjinnazi "Sllavço Stojmenski" procesin mësimor e realizon me gjithsej 520 nxënës në vitin shkollor 2022/23. Sipas përgjigjes për kërkesën për qasje falas tek informacionet me karakter publik, shërbimet që financohen me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve janë:

- » Fotografimi i nxënësve;
- » Sigurimi i nxënësve;
- » Ekskursione.

Tabela nr. 7 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve të SHMK Gjimnazi “Sllavço Stojmenski”

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurim i nxënësve	43,000 denarë	100 denarë
Foto në grup	63,920 denarë	170 denarë
Fotografi për tablo	216,000 denarë	1,500 denarë
Ekskursion një ditore	56,100 denarë	550 denarë
Ekskursion profesional-kërkimor	400,500 denarë	4,400 denarë
Gjithsej	779,520 denarë	

Në SHMK “Kole Nehtenin” në vitin shkollor 2022/23, janë regjistruar gjithsej 691 nxënës. Sipas përgjigjes në kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, shërbimet që financohen me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve janë:

- » Fotografimi i nxënësve;
- » Sigurim i nxënësve;
- » Ekskursionet;

Tabela nr. 8 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve të SHMK “Kole Nehtenin”

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurim i nxënësve	69,500 denarë	100 denarë
Fotografi për tablo	269,100 denarë	1,300 denarë
Ekskursion i fundit shkollor	1,432,250 denarë	16,850 denarë
Ekskursion profesional-hulumtues	532,800 denarë	3,700 denarë
Gjithsej	2,303,650 denarë	

SHMK “Jane Sandanski” procesin mësimor e realizon me gjithsej 520 nxënës në vitin shkollor 2022/23. Sipas përgjigjes për kërkesën për qasje falas tek informacionet me karakter publik, shërbimet që financohen me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve janë:

- » Fotografimi i nxënësve;
- » Sigurimi i nxënësve;
- » Ekskursionet;
- » Uniformat
- » Festa për maturën.

Tabela nr. 9 – Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve të SHMK “Jane Sandanski”

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurim i nxënësve	66,500 denarë	100 denarë
Prokurimi i uniformave për nxënësit e vitit të 1-rë	148,500 denarë	1,650 denarë
Foto në grup	47,400 denarë	100 denarë
Fotografi për nxënësit e vitit të 2-të për legjitimacion studentor	45,150 denarë	350 denarë
Fotografi për tablo dhe almanak	273,000 denarë	1,500 denarë
Mbrëmja e maturës për nxënësit e viteve të 4-ta	273,000 denarë	1,500 denarë
Ekskursioni i fundit shkollor	2,932,250 denarë	15,850 denarë
Gjithsej	3,785,800 denarë	

Në SHMK “Dimitar Mirasçiev” në vitin shkollor 2022/23 janë regjistruar gjithsej 94 nxënës. Sipas përgjigjes ndaj kërkesës për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, shërbimet që financohen me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve janë:

- » Fotografimi i nxënësve;
- » Sigurim i nxënësve;
- » Festa e mbrëmjes së maturës;

Tabela nr. 10 - Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e mjeteve të mbledhura prej prindërve të nxënësve të SHMK “Dimitar Mirasçiev”

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurim i nxënësve	8,100 denarë	100 denarë
Fotografi për tablo	14,400 denarë	1,200 denarë
Festa e mbrëmjes së maturës	16,250 denarë	1,250 denarë
Gjithsej	38,750 denarë	

Në vitin shkollor 2022/23, në QSHSHM “Sergej Mihajllor” janë regjistruar gjithsej 144 nxënës të rregullt. Sipas përgjigjes ndaj kërkesës për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, shërbimet që financohen me paratë e mbledhura prej prindërve të nxënësve janë:

- » Fotografimi i nxënësve;
- » Sigurim i nxënësve;

Tabela nr. 11 - Shërbimet, çmimet për secilin shërbim dhe shuma totale e fondeve të mbledhura prej prindërve të nxënësve QSHSHM “Sergej Mihajllor”

Lloji i shërbimit/produktit	Vlera totale në denarë	Çmimi për një nxënës në denarë
Sigurim i nxënësve	14,000 denarë	100 denarë
Fotografim për tablo	35,200 denarë	1,100 denarë
Gjithsej	49,200 denarë	

RREGULLORET PËR REALIZIMIN E EKSKURSIONEVE DHE AKTIVITETEVE TË TJERA JASHTËSHKOLLORE PËR ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM

Shkollat fillore në Shtip aktivitetet e tyre jashtëshkollore dhe ekskursionet i realizojnë në përputhje me Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve, piknikëve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore për nxënësit e shkollave fillore, të cilën publiku mund ta gjejë në faqen e internetit të Ministrisë për Arsim <https://mon.gov.mk/stored/document/Pravilnik-za-ekskurzii-vo-osnovno-obrazovanie.pdf>.

Për zgjedhjen e një subjekti juridik për realizimin e ekskursioneve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore zbatohet një procedurë me shpallje të thirrjes publike të paktën në 2 gazeta ditore, si dhe në një vend të dukshëm në shkollë. Ndodh që asnjë ofertues të mos paraqitet në këto thirrje për shkakun se nuk e përcjellin shtypin ditor. Për këtë arsye, shkollat e kanë praktikën që kur të publikojnë njoftimin, kontaktojnë të paktën 3 operatorë ekonomikë dhe kërkojnë oferta. Përbërja e Komisionit që e bën përzgjedhjen dhe vlerësimin e ofertave është nga përfaqësues të prindërve dhe mësuesve si dhe kriteri për zgjedhjen e ofertës më të favorshme është çmimi më i ulët.

Sipas rregullores, për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore për nxënësit e shkollave të mesme, ekskursionet shkollore mund të jenë:

- ✓ ekskursione lidhur me temat dhe përmbajtjet e kurrikulës;
- ✓ ekskursione të fundit shkollore;
- ✓ ekskursione profesionale-kërkimore dhe
- ✓ ekskursione sportive dhe rekreative.

Në procedurën e përzgjedhjes së ofertuesve, si në rastin e shkollave fillore, thuhet se procedura e përzgjedhjes bëhet me shpallje publike, ku ceken kushtet dhe kriteret minimale që duhet t'i plotësojnë ofertuesit dhe shpallja publikohet në dy gazeta ditore dhe në tabelën e shpalljeve ose në një vend të dukshëm në shkollë, që paraqet rrezik për shkak se vështirë që dikush i ndjek aktivitetet përmes gazetave ditore dhe jo të gjithë do ta vizitojnë shkollën në çdo kohë për të marrë informacion nëse shkolla ka publikuar ndonjë shpallje. Këtu, ndoshta duhet të bëhet një ndryshim në rregulloren me qëllim që të zmadhohet transparenca e këtyre procedurave, ashtu që edhe me rregulloren të parashihet që këto prokurime duhet të zbatohen në përputhje me Ligjin për Prokurime Publike në mënyrë që çdo ofertues i interesuar të ketë mundësi për të marrë pjesë.

Për prokurimet e tjera (fotografim, sigurim i nxënësve, uniforma shkollore) që zbatohen, shkollat nuk kanë miratuar rregullore apo procedura të posaçme. Për këto prokurime, shkollat i referohen Statutit të shkollës, në të cilin është përcaktuar që për prokurimet që zbatohen vendos Këshilli i prindërve. Nuk ka akte të veçanta për kriteret me të cilat bëhet përzgjedhja e operatorëve ekonomikë për ndonjë prokurim konkret, por kjo bëhet pasi prindërit, të cilët janë anëtarë në Këshillin e prindërve, të shqyrtojnë dhe vlerësojnë se cila ofertë është më ekonomike.

